

## **MATERIAL MËSIMOR**

**Në mbështetje të mësuesve të profilit mësimor**

### **SHERBIME TE UDHETIMIT DHE TURIZMIT** **Niveli IV i KSHK** **NR. 9**

**Ky material mësimor i referohet:**

➤ **Lëndës profesionale:**“ GJEOGRAFI E TURIZMIT” (L-13-491-19). Kl. 12

➤ **Temave mësimore:**

- Gjeografia dhe turizmi
- Gjeografia e Shqipërisë dhe e rajoneve të saj
- Rajoni verior dhe verilindor (veçoritë gjeomorfologjike, flora fauna, klima, aspektet socio-ekonomike, zhvillimi real dhe potencial i turizmit)
- Rajoni juglindor ((veçoritë gjeomorfologjike, flora, fauna, klima, aspektet socio-ekonomike, zhvillimi real dhe potencial i turizmit)
- Rajoni jugor(veçoritë gjeomorfologjike, flora, fauna, klima, aspektet socio-ekonomike, zhvillimi real dhe potencial i turizmit)
- Rajoni perëndimor ((veçoritë gjeomorfologjike, flora, fauna, klima, aspektet socio-ekonomike, zhvillimi real dhe potencial i turizmit)
- Gjeografia e Ballkanit perëndimor
- Gjeografia e Evropës
- Gjeografia e Botës

**E përgatitën:**

**Prof. Dr. Dhimitër Doka**  
**Afërdita Alizoti Mëhilli**

**Tiranë 2020**

# Tema mësimore nr.1: Gjeografia dhe turizmi

## 1. 1. Gjeografia, objekti dhe rëndësia e studimit

Gjeografia cilësohet si njëra nga shkencat më të vjetra të dijes njerëzore, e cila lindi si nevojë e përshkrimit të Tokës dhe fenomeneve të ndryshme që ndodhin në të. Por, gjatë udhëtimit të saj të gjatë, bashkë me zhvillimin e njerëzimit dhe transformimit prej tij të hapësirës, evoluoi dhe u zhvillua edhe objekti i studimit të gjeografisë. Kështu ajo kaloi gradualisht nga një gjeografi thesht përshkruese, drejt asaj vlerësuese dhe analizuese të dukurive të shumta natyrore dhe humane që do të shoqëronin në shekuj si zhvillimet globale, ashtu edhe ato rajonale dhe lokale. Në këtë mënyrë Gjeografia ka dhënë dhe vazhdon të japi një kontribut të rëndësishëm në analizën e efekteve, pasojave dhe prognozave që ndodhin gjatë transformimit të hapësirave të ndryshme, duke u përpjekur që ti japi në kohë përgjigje pyetjeve se: ku, çfarë, si dhe pse ndodhin dhe zhvillohen fenomene të ndryshme në hapësirë.

Bashkë me evoluimin e objektit të gjeografisë u zgjerua përmbajtja e saj me disiplina të ndryshme që e përbëjnë atë. Kështu krahas gjeografisë së përgjithshme vend po kaq të rëndësishëm do zinte edhe ajo rajonale. Ndërkohë që gjeografia e përgjithshme do ta zgjeronte objektin e saj si përsa i përket gjeografisë fizike, ashtu edhe asaj humane, ajo rajonale do vazhdonte ta fokusonte trajtimin e saj në hapësira dhe rajone të përmasave gjithnjë e më të vogla. Krahas tyre do të vinte gjithnjë e duke u rritur edhe rëndësia e metodave të trajtimit gjeografik, duke kaluar nga hartografia tradicionale drejt informatizimit dhe aplikimit gjeografik.

Fig. 1: Skema e ndërtimit të shkencës së Gjeografisë



Siç shikohet edhe nga skema e mësipërme, gjeografia si shkencë përbëhet nga dy pjesë kryesore, ajo e përgjithshme dhe rajonale. Gjeografia e përgjithshme nga ana e saj përmbledh gjeografinë fizike dhe atë humane, ku secila prej tyre trajton një sërë çështjesh që kanë të bëjnë si me natyrën, ashtu edhe me veprimtarinë e njeriut. Ndërsa objekt i gjeografisë rajonale është studimi në kompleks i fenomeneve, dukurive dhe objekteve gjeografike, natyrore dhe njerëzore, të cilat ndodhin në rajone të ndryshme të rruzullit tokësor. Ajo studion vendosjet, proceset, modelet ambientalo-humane si dhe shkaqet e pasojat rajonale gjeografike. Në këtë mënyrë ajo konsiderohet një shkencë ndërdisiplinare, pasi rajoni ndërthur çështje nga shumë fusha, të natyrës, njeriut, marrdhënieve të bashkveprimit mjedis-njeri etj.

Në kuptimin e tij më të thjeshtë një rajon është parasëgjithash një hapësirë e caktuar gjeografike me tipare dhe veçori natyrore, kulturore dhe ekonomike, të cilët e dallojnë nga rajonet e tjera. Një përkufizim i tillë i rajonit do të ishte megjithatë e paplotë, pasi rajoni e merr kuptimin e tij të

*plotë kur në të krijohen dhe veprojnë aktorë dhe struktura të tëra lidhjesh dhe bashkëveprimi midis peisashit natyror, zhvillimit historik e kulturor, atij social, ekonomik dhe politik.*

Pjesë e gjeografisë humane dhe asaj rajonale është pikërisht edhe Gjeografia e Turizmit, e cila ka si objekt trajtimin e ndryshimeve që i ndodhin hapësirës si rezultat e zhvillimit turistik dhe analizën e efekteve të ndryshme që rrjedhin nga ky zhvillim.

Për të kuptuar më mirë trajtimin e turizmit në kuadër të Gjeografisë së Turizmit, ka rëndësi fillimisht njohja dhe analiza e fenomenit turizëm, rëndësisë dhe përmasave që ai ka marrë gjithnjë e më shumë kudo në botë.

## **1.2 Turizmi si fenomen dhe rëndësia e shumanëshme e tij**

Turizmi përbën sot një nga fenomenet më të rëndësishme dhe më masive të rruzullit tokësor. Rëndësia e tij ka ardhur gjithnjë në rritje dhe ai cilësohet si aktivitet prioritar i shekullit të 21-të. Një gjë e tillë bazohet si në kontributin me të ardhura që turizmi jep në kuadër të ekonomisë botërore, ashtu edhe në sigurimin e vendeve të punës, ku mesatarisht në çdo 10 vende pune në rang botëror të paktën njëri prej tyre lidhet direkt apo indirekt me sektorin e turizmit. Gjithashtu turizmi është një fenomen që shfaqet në shumë forma e aktivitete dhe që tërheq miliona e miliona njerëz të rruzullit tokësor.

Bazuar në rëndësinë e veçantë që paraqet fenomeni turizëm sot kudo në botë, mund të veçohen disa nga tiparet kryesore që e dallojnë atë në krahasim me shumë fenomene të tjerë, ndër të cilët rendisim:

1. **Fenomen mjaft masiv**, duke përfshirë çdo vit mbi 1 miliardë njerëz të rruzullit tokësor, të cilët bëhen pjesë të lëvizjes turistike ndërkombëtare kudo në botë. Kjo tendencë pritet të rritet edhe më tej dhe sipas prognozave të OBT (Organizata Botërore për Turizmin) është parashikuar që ky numër të arrijë në 1.8 miliardë derin në vitin 2030.

2. Aktivitet me **rëndësi shumë të madhe ekonomike**, duke e rënditur turizmin si njërin nga më kryesorët në kuadër të ekonomisë botërore në përgjithësi dhe të vendeve të ndryshme në veçanti. Kjo rëndësi shprehet si në të ardhurat e shumta valutore që sigurohen nëpërmjet turizmit, ashtu edhe në vendet e punës që ai krijon. Duke u bazuar në këtë rëndësi, me të drejtë turizmi cilësohet shpesh si "*industria e bardhë*".

3. **Fenomen shumë i përhapur** në rruzullin tokësor. Në këtë kuptim harta turistike ka përfshirë sot gjithë pjesët e planetit tonë dhe pothuajse nuk ka më cep të rruzullit që të mos jetë "shkelur" nga këmba e turistit.

4. **Një fenomen mjaft dinamik**. Zhvillimi i turizmit ka njohur një dinamikë mjaft të shpejtë rritje për shumë vende dhe popuj të botës. Kuptohet që ritmet e rritjes kanë ndryshuar në varësi të faktorëve që kanë ndikuar, siç është në kohën që po jetojmë edhe pandemia e koronavirusit që ka përfshirë gjithë botën dhe ka goditur rëndë para së gjithash pikërisht turizmin.

Evoluimi i vazhdueshëm i shoqërisë, rritja gjithnjë e më shumë e shkallës së urbanizimit të hapësirës, zhvillimi i teknikës dhe teknologjisë, ndryshimi me këto i raporteve midis punës dhe pushimit në favor të kësaj të fundit, ardhja në rritje e mirëqenies së popullsisë etj., kanë qenë ndër faktorët kryesorë që çuan në rritjen gjithnjë e më tepër të kërkesës së njerëzve për kalimin e pushimit të tyre duke marrë pjesë në turizëm.

Me kalimin e kohës dhe zhvillimet e rëndësishme që ndodhën në botë u krijuan gjithnjë e më shumë edhe kushtet ekonomike dhe shoqërore për zhvillimin e turizmit, të cilat kanë pasur në themel të tyre dy elemente të domosdoshme: **kohën e lirë** dhe **mjetet financiare** të nevojshme për të bërë kështu të mundur lëvizjen e njerëzve për qëllime turistike.

### 1. 3. Koncepti turizëm dhe evolucioni i tij

Origjina e fjalës turist dhe turizëm mendohet të jetë nga Britania e Madhe, ku që në shekullin XVII filluan të përdoren këto terma. Studiues të ndryshëm të fenomenit turizëm kanë konkluduar se në themel të konceptit turist dhe turizëm qëndron fjala në anglisht *the tour*, nga e cila ka marrë edhe popullaritetin më të madh të saj. Domethënia e kësaj fjale konsiston në fenomenin e lëvizjes, udhëtimit dhe shëtitjes. Kuptimi mbi turizmin përdoret kudo sot në botë si fenomen që ka të bëjë me lëvizjen e njerëzve me qëllim pushimin, çlodhje, argëtimi, por edhe për qëllim njohje, arsimimi, kulture etj.

#### *Po si kanë evoluar konceptet turizëm dhe turist?*

Ekzistojnë koncepte dhe përkufizime të ndryshme rreth konceptit turist. Kuptimi klasik i këtij koncepti mbështetet në faktin e qëndrimit me fjetje të personit turist në një vend tjetër, larg vendbanimit të tij të përhershëm. Sipas këtij kuptimi "*Turistë quhen ata persona, të cilët udhëtojnë në vende të huaja për shkak të pushimit, kureshtjes, argëtimit, aktiviteteve, biznesit etj., të cilët bëjnë turne në ato vende, të cilat si rregull më parë i kanë vizituar organizatorët e tyre*" (E. Littre). Nga ky përkufizim rezulton se turist mund të cilësohej vetëm ai që ka udhëtuar jashtë vendit të tij dhe me këtë tentohej që të bëhej edhe dallimi midis fjalëve turizëm dhe udhëtim, apo turist dhe udhëtar. Bazuar në këtë shpjegohet edhe arsyeja se historikisht është zhvilluar më parë turizmi i të huajve që vizitojnë vende të ndryshme, se sa lëvizja turistike e banorëve vendas që vizitojnë pjesë të ndryshme të vendit të tyre.

Me kalimin e kohës një faktor tjetër që është marrë parasysh ka qenë distanca e largimit të personit turist nga vendbanimi i tij p.sh. jo më pak se 50 km. Në vendet në zhvillim konsiderohen edhe sot turistë si rregull vetëm ata që janë shtetas të huaj.

Institucioni më i rëndësishëm ndërkombëtar që merret me turizmin është Organizata Botërore e Turizmit (OBT) në anglisht UNWTO, e cila vepron në kuadër të Kombeve të Bashkuara. Detyra e kësaj organizate është grumbullimi dhe publikimi i statistikave dhe informacioneve rreth gjendjes së zhvillimit të turizmit në botë. Në këtë kuadër kjo organizatë në njërin nga botimet e saj që në vitin 1993 ka dhënë edhe përkufizimin rreth konceptit "turist", i cili është pranuar si përkufizim përgjithësues nga gjithë vendet e botës anëtare të kësaj organizate. Sipas këtij përkufizimi turist quhet... "*personi (vizitori apo udhëtuesi), i cili bën një udhëtim jashtë mjedisit të tij të zakonshëm të banimit për një kohë maksimale deri në një vit, me qëllime apo motive të caktuara (kalim i kohës së lirë, argëtim, çlodhje, vizita, kurim, biznes etj). Turisti është i huaj në vendin turistik, i përkohshëm dhe vetëm si konsumator i të mirave materiale e jo si krijues i tyre*" (UNWTO 1993)

Nga analiza e këtij përkufizimi del në pah që ai përmban tre aspekte kryesore:

1. **Ndërrimi i vendqëndrimit.** Turist është ai person, i cili lëviz në hapësirë nga vendi i tij banimit drejt atij të qëllimshëm turistik. Largësia në distancë dhe kalimi apo moskalimi i kufirit lokal apo shtetëror nuk merren në këtë rast si kushte përcaktuese.

2. **Qëndrimi i përkohshëm.** Lëvizja në hapësirë si turist është e përkohshme dhe maksimumi kohor i lëvizjes dhe qëndrimit si turist mund të jetë maksimumi një vit. Në varësi të kohqëndrimit të turistëve ata cilësohen si turistë me fjetje dhe ditorë.

3. **Qëllimi apo motivi turistik.** Janë të shumëllojshme motivet e lëvizjes turistike, duke filluar nga kalimi thjesht i kohës së lirë, e duke vazhduar me motive biznesi, fetare, shëndeti, sporti etj.

#### 1. 4. Turizmi – objekt i studimit gjeografik

Në kuadrin e shkencave të shumta që merren me studimin e turizmit, një vend tepër të rëndësishëm zë shkencat e gjeografisë. Kjo për faktin se kalimi i kohës së lirë dhe turizmi realizohet në hapësira të caktuara gjeografike, duke sjellë efekte e pasoja të shumta në mjedisin natyror, ekonomik dhe shoqëri. Krahas efekteve pozitive të aspektit ekonomik e financiar dhe të plotësimit të nevojave të njerëzve për pushim e çlodhje, argëtim dhe edukim, zhvillimin e turizmit në hapësira të caktuara gjeografike mund ta shoqërojnë edhe mjaft efekte negative që kanë të bëjnë me prishjen e ekuilibrave natyrorë, ekonomikë e socialë, kur zhvillimi i turizmit nuk bëhet në përputhje me mundësitë e potencialeve natyrore e kulturore që ofrojnë hapësira të ndryshme gjeografike.

Në përkufizimin e saj të përgjithshëm Gjeografia e Turizmit cilësohet si shkencë që studion *ofertën turistike, shpërndarjen e saj, mënyrën e organizimit e të përdorimit turistik të hapësirës, strategjitë, organizmat, infrastruktura si dhe elementët e mbrojtjes e të ripërtëritjes së ofertës turistike.*

Objekti i gjeografisë turistike do të bëheshin gjithashtu të gjitha aktivitetet e njerëzve në hapësira të ndryshme gjeografike gjatë kalimit të kohës së lirë dhe pushimit në to. Kështu gjeografia turistike do të zhvillohej gradualisht nga një disiplinë klasike përshkruese, drejt analizës shkencore të zonave turistike me të gjitha efektet pozitive dhe negative që shoqërojnë zhvillimin turistik të tyre.

Një vend gjithnjë e më të rëndësishëm në studimin gjeografik të turizmit do të merrte analiza e efekteve ekologjike që shoqërojnë zhvillimin e turizmit. Kjo për arsyen se turizmi dhe mjedisi natyror janë shumë të lidhura midis tyre dhe nuk mund të kuptohen pa njëri-tjetrin.

Studimi i ofertës turistike primare që ka të bëjë me potencialet natyrore dhe historiko-kulturore që ofron një vend, zonë apo rajon i caktuar gjeografik, përbën një ndër qëllimet kryesore në trajtimin gjeografik të tij.

Në lidhje të ngushtë me këto potenciale dhe faktorë që ndikojnë në zhvillimin e turizmit analizohen motivet, format dhe llojet e lëvizjes turistike kudo në botë, si dhe arrihet në klasifikimin e hapësirave gjeografike mbi bazën e zhvillimit të turizmit në to.

Të gjitha këto së bashku bënë që fenomeni turizëm, krahas shkencave të tjera, të zhvillohet edhe si objekt i studimit gjeografik. E në të vërtetë ekzistojnë një sërë studimesh gjeografike nën titujt: “Gjeografia e Turizmit”, “Gjeografia e Kohës së Lirë” apo “Gjeografia e Rekreacionit” etj.

#### 1. 5. Por çfarë përfshin trajtimi i mirfilltë gjeografik i turizmit?

Koncepti i parë mbi gjeografinë turistike do të paraqitej që në vitin 1905 nga autori *Shtrander*. Si detyra të kësaj discipline të re ai do të konsideronte studimin e ndikimeve të faktorëve natyrorë dhe kulturorë në zhvillimin e turizmit, si dhe paraqitjen hartografike të zonave turistike. Ndërsa autori *Wegener* do të theksonte në studimin e tij klasik të vitit 1929 nga njëra anë lidhjet dhe efektet e ndërsjellta midis turizmit dhe faktorëve të tjerë si vendbanimet, ekonomia, transporti etj, ndërsa nga ana tjetër ndikimet e turizmit në pamjen e peizazhit natyror.

Impulse vendimtare të zhvillimit, gjeografisë turistike do t'i jepte autori *Poser*, i cili me studimin e tij të vitit 1939 do të jepte kontribut shumë të rëndësishëm si në trajtimin e bazave natyrore për zhvillimin e turizmit, ashtu edhe në përcaktimin e llojeve të lëvizjes turistike dhe në klasifikimin e vendeve dhe hapësirave turistike. Mbi këtë bazë autori Poser vlerësohet me të drejtë si themeluesi i Gjeografisë së Turizmit.

Pas Luftës së Dytë Botërore ndodhën një sërë prurjesh të reja në trajtimin gjeografik të turizmit.

Objekti i studimit të tij, krahas analizës së potencialeve natyrore dhe transformit të mjedisit nga përdorimi turistik, do të zgjerohej dukshëm edhe drejt trajtimit të shumë aspekteve të reja socio-ekonomike me ndikimin e tyre në zhvillimin e turizmit, metodologjisë së studimit gjeografik në këtë fushë, si dhe dhënien e shembujve të studimit nga vende dhe zona të ndryshme turistike.


Gjithë këto zhvillime të gjeografisë së turizmit bënë që në vitet '90 të shekullit XX kjo gjeografi të zhvillohet plotësisht nga një shkencë përshkruese drejt asaj praktike dhe aplikative.

Bashkë me këtë evoluim dhe zgjerim të objektit të studimit në kuadër të gjeografisë turistike, lindi edhe nevoja e rikonceptimit të përkufizimit se, çfarë është Gjeografia e Turizmit dhe me se merret ajo? Cilat janë synimet kryesore të studimit gjeografik të turizmit dhe ku orientohet ato?

Për tu dhënë përgjigje këtyre pyetjeve autorë të ndryshëm bashkohen në përkufizimin e sotëm, se: *“Gjeografia e Turizmit është shkencë që merret me studimin e strukturave dhe proceseve që ndodhin në hapësirë, si rezultat i zhvillimit të turizmit”*.

Njëkohësisht me evoluimin dhe zgjerimin e objektit të studimit të Gjeografisë së Turizmit lindi edhe çështja e pozicionimit të kësaj disipline krahas pjesëve të tjera përbërëse të shkencës së Gjeografisë. Skema e mëposhtme tregon pikërisht vendin që zë Gjeografia e Turizmit në trungun e shkencës së Gjeografisë në përgjithësi.

Fig. 2: Vendi i gjeografisë së turizmit në trungun e shkencës së gjeografisë



Nga skema e mëposhtme duket qartë se Gjeografia e Turizmit është pjesë përbërëse e Gjeografisë Humane dhe Ekonomike dhe se lidhjet më të ngushta të saj janë me disiplinat e tjera përbërëse të tyre, si me Gjeografinë Sociale, Gjeografinë e Vendbanimeve, Tregtisë, Transportit etj. Ndërkohë që Gjeografia e Turizmit ka edhe pozicionin dhe luan rolin e një disipline ndërlidhëse midis saj dhe pjesëve të tjera të Gjeografisë Humane e Ekonomike me Gjeografinë Fizike. Kjo sepse pozicioni gjeografik dhe rezurset e tjera natyrore të një hapësire të caktuar gjeografike përbëjnë gjithashtu potenciale shumë të rëndësishme turistike dhe me reflektim në gjithë efektet e tjera socio-ekonomike që sjell turizmi.

## Tema mësimore nr.2: Gjeografia e Shqipërisë dhe e rajoneve te saj

### 2.1. Pozita gjeografike

Republika e Shqipërisë shtrihet në Evropën Juglindore, duke zënë një vend shumë të rëndësishëm në pjesën perëndimore të Gadishullit Ballkanik e me dalje të gjerë në detet Adriatik dhe Jon. Vendet kufitare të Republikës së Shqipërisë janë Mali i Zi dhe Kosova në Veriperëndim, Veri dhe Verilindje; Maqedonia e Veriut në Lindje, Greqia në Juglindje dhe Jug.

Gjatësia më e madhe e kufirit tokësor ndan Republikën e Shqipërisë me Malin e Zi, Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut. Pjesa që mbetet e kufirit tokësor ndan Shqipërinë me Greqinë. Në përgjithësi, kufiri tokësor është malor dhe i vështirë për t'u kaluar. Kalimi i tij realizohet vetëm nëpërmjet disa qafave malore dhe luginave lumore, si Hani i Hotit në kufi me Malin e Zi; lugina e Drinit të Bardhë (Qafë Morini) dhe Qafë Morina në kufi me Kosovën; Qafë Thana, Shën Naumi dhe Gorica në kufirin me Maqedoninë e Veriut; Kapshtica, Tri Urat, Kakavija dhe Qafë-Botë në kufirin me Greqinë etj. Në perëndim dhe jugperëndim kufiri është detar dhe kalon në ujërat e detit Adriatik dhe Jon. Ky kufi ndodhet 12 milje nga bregu i detit, dhe kalon mes për mes kanalit të Otrantos në detin Adriatik. Ky kanal e ndan Shqipërinë nga Italia vetëm me 72 km gjerësi. Gjatësia e vijës bregdetare të Shqipërisë arrin në 450 km. Brenda këtyre kufijve sipërfaqja e Republikës së Shqipërisë është 28.748 km<sup>2</sup>, që do të thotë gati e barabartë me sipërfaqen e Belgjikës.



*Pozita gjeografike e Republikës së Shqipërisë*

### 2.2. Rëndësia e pozitës gjeografike në rajon dhe Evropë

Pozita gjeografike e Shqipërisë vlerësohet si tepër e përshtatshme jo vetëm për zhvillimin e gjithanshëm të saj, por edhe për integrimin rajonal dhe evropian. Prandaj, me të drejtë Shqipëria është cilësuar shpesh si **“portë hyrëse në Ballkan”**, apo si **“urë lidhëse në Evropën Juglindore”**. Rrugët më të rëndësishme që lidhin pjesën perëndimore me atë lindore të Evropës Juglindore, kanë kaluar dhe po kalojnë, edhe aktualisht, nëpërmjet Shqipërisë.

Megjithatë, kjo pozitë e favorshme gjeografike e Shqipërisë, si dhe gjithë potencialet e tjera natyrore të lidhura me të, nuk janë shfrytëzuar gjithmonë siç duhet në shërbim të zhvillimit të

gjithanshëm socioe-konomik të vendit, duke u shoqëruar historikisht herë me rritje të kësaj rëndësie, e herë me rënie të saj. Kështu që në Iliri dhe Antikit, ilirët dalloheshin jo vetëm si lundërtarë të zot, por edhe si tregtarë të fuqishëm, të cilët i shfrytëzonin mjaft mirë kushtet e favorshme që u krijonte pozita gjeografike me dalje të gjërë në detin Adriatik dhe Jon. Në atë kohë vlerësohej për shembull veçanërisht ajo që quhej Rruga (Via) Egnatia, e cila ishte rruga më e rëndësishme tregtare e kohës që lidhte dy qendrat e botës së atëherëshme (Romën me Kostandinopojën) dhe meqenëse një pjesë e rëndësishme e saj kalonte nëpër Shqipëri, do të shoqërohej me efekte shumë të rëndësishme për vendin tonë dhe gjithë rajonin.

Gjatë periudhës së Mesjetës dhe pushtimit të gjatë Osman drejtimi i lidhjeve të vendit do të orientohej më së tepërmi drejt Lindjes, duke e zbehur kështu roli dhe efektet tradicionale të pozitës gjeografike me lidhjet e saj drejt Perëndimit.

Ndërkohë që shpallja e Pavarësisë dhe periudha e mbretit Zog do të rikthente orientimin dhe rëndësinë e pozitës gjeografike drejt Perëndimit.

Izolimi i tejskajshëm i vendit gjatë regjimit komunist (1945-1990), do të ulte në minimum rolin e pozitës gjeografike në zhvillimin e vendit dhe lidhjet me rajonin dhe Evropën.

Situata do të ndryshonte tërësisht pas ndryshimeve politike dhe hapjes së vendit në vitet 1990/1991, ku pozita gjeografike do të shfrytëzohej shumë më mirë për lidhje të ndryshme ekonomike e tregtare, për qarkullimin e njerëzve dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj.

Bazuar në zhvillimet e derisotme, roli dhe rëndësia e pozitës gjeografike dhe rezurseve të tjera natyrore e humane të lidhura me të që ka Shqipëria, mbetet një mundësi mjaft e mirë për t'u shfrytëzuar akoma edhe më shumë në të ardhmen në shërbim të zhvillimit socio-ekonomik të vendit. Realizimi i projekteve të tilla, si: Korridori VIII, Gazsjellësi TAP, Korridori Turistik (Kroaci, Mali i Zi, Shqipëri) etj, do të rrishte ndjeshëm rolin e pozitës gjeografike në zhvillimin e mëtejshëm të vendit dhe në integrimin rajonal dhe evropian.

### **2.3. Rajonizimi gjeografik i Shqipërisë**

Për Shqipërinë kanë ekzistuar deri më sot rajonizime të ndryshme gjeografike, si ai fiziko-gjeografik, i cili i ndan vendet në njësi të mëdha fiziko-gjeografike dhe ku në secilin prej tyre analizohen me radhë të gjithë komponentët e mjedisit gjeografik. Kështu, në bazë të këtij rajonizimi dallojmë për Shqipërinë 4 rajone fiziko-gjeografike: Krahina Malore Veriore, Krahina Malore Qendrore, Krahina Malore Jugore dhe Ultësira Perëndimore.

Gjithashtu, krahas këtyre rajoneve të përgjithshme fiziko-gjeografike, ekzistojnë edhe rajonizime të tjera në bazë të elementeve të veçanta të mjedisit gjeografik, siç është rajonizimi klimaterik, gjeologjik, pedologjik, bimor etj.

Për sa u përket rajoneve ekonomike dhe humane nuk ka pasur përcaktim të qartë të tyre. Ato janë përcaktuar më së shumti në bazë të dominimit të degëve të veçanta të ekonomisë, apo veçorive gjuhësore, kulturore, traditës etj. Kështu, në bazë të dialektit gjuhësor dallohet Gegëria dhe Toskëria me kufi lumin Shkumbin, apo në bazë të veçorive kulturore dhe traditës krahina të tilla, si Labëria, Myzeqeja, Mokrra, Martaneshi, Dukagjini, Hasi etj.

Duke filluar nga mesi i viteve '90, në kuptimin shqiptar mbi rajonin filloi të zërë më shumë vend koncepti klasik, sipas të cilit "...rajoni është territori në të cilin janë të vendosura lidhje të qëndrueshme dhe të ekuilibruara midis shoqërisë njerëzore dhe mjedisit natyror".

Mbi këtë bazë është synuar drejt një rajonizimi të vetëm gjeografik, qëllimi i të cilit është trajtimi në unitet dhe bashkëveprim të gjitha dukuritë gjeografike të mjedisit natyror, zhvillimit ekonomik, human etj.




Në këtë mënyrë veçohen sot në Shqipëri katër rajone gjeografike:

1. **Rajoni Verior-Verilindor**
2. **Rajoni Perëndimor**
3. **Rajoni Juglindor**
4. **Rajoni Jugor**

Secili nga këto rajone përfaqëson një unitet më vete me kufij të qartë natyrorë dhe me veçori specifike të mjedisit natyror, zhvillimit ekonomik dhe atij human.

*Harta e rajoneve gjeografike të Shqipërisë*



#### **2.4. Kriteret e rajonizimi**

Rajonizimi i Shqipërisë në katër rajonet e mësipërme mbështetet në kriteret e qartë të veçorive natyrore, demografike dhe ekonomike që i dallojnë dukshëm këto rajone nga njëri-tjetri. Mbi këtë bazë secili nga këto rajone përfaqëson një unitet më vete me kufij të qartë natyrorë dhe me veçori specifike të mjedisit natyror, zhvillimit ekonomik dhe atij human.

Në themel të këtij rajonalizimi qëndron trajtimi i lidhjeve të ndërsjellta natyrë-shoqëri-ekonomi që ndodhin në hapësira të caktuara gjeografike, analiza e strukturave dhe proceseve që krijohen, e në këtë mënyrë se si organizohet dhe funksionon territori për një menaxhim sa më të mirë të tij. Mbi këtë bazë mund të realizohen analiza dhe përcaktohen tregues të ndryshëm që paraqesin gjendjen e nivelit ekonomik, human dhe kulturorë në nivel rajonal e lokal, për të nxjerrë kështu në pah dallimet dhe të përbashkat që ekzistojnë midis zonave të ndryshme dhe mbi këtë bazë përfshirjen e tyre në një administrim dhe zhvillim sa më të qëndrueshëm dhe funksional.

Ndryshimet e periudhës pas vitit 1990 e në vazhdim në Shqipëri kanë thelluar edhe më tej diferencimet e mëdha në zhvillimin midis rajoneve të vendit. Lëvizja masive migruese e popullsisë, dhe bashkë me të edhe kapitali ekonomik e human, kanë sjellë ndryshime të mëdha ndërrajonale. Kështu, krahas Rajonit Perëndimor të vendit, para së gjithash zona Tiranë–Durrës, ku po koncentrohet gjithnjë e më tepër popullsia, ekonomia dhe kapitalet, vërehen edhe rajonet periferike, që po shkojnë drejt braktisjes dhe humbjes së rëndësisë së tyre. Një situatë e tillë po shoqërohet me një sërë problemesh sociale, ekonomike dhe mjedisore si në rajonet e vendosjes së popullsisë, ashtu edhe në ato të largimit. Pikërisht kjo kërkon studime të mirëfillta shkencore, jo vetëm në kuadrin e një vendbanimi, komune apo rrethi të veçantë, por në kushtet e një hapësire më të gjerë rajonale dhe ndërrajonale.

#### **2.5 Rajonizimi dhe integrimi evropian**

Zhvillimet rajonale dhe lokale janë bërë aktualisht objekt shumë i rëndësishëm diskutimi dhe

studimi, jo vetëm për vendet e reja anëtare të Bashkimit Evropian, por edhe për vendet e tjera në transformim dhe që synojnë të integrohen në BE, siç është edhe rasti i Shqipërisë. Kjo sepse një nga objektivat më të rëndësishme në rrugën e zgjerimit të Bashkimit Evropian është pikërisht mbështetja e rajoneve pak të zhvilluara dhe nxitja e potencialeve të tyre të zhvillimit.

Mbështetja e Shqipërisë nga Bashkimi Evropian për integrimin e vendit në të, lidhet kështu midis të tjerash edhe me ngritjen dhe funksionimin e strukturave të zhvillimit rajonal dhe lokal. Në këto kushte merr rëndësi të veçantë përfaqja e zhvillimeve rajonale me rregullat dhe kriteret e vendosura nga Bashkimi Evropian. Në këtë mënyrë mund të sigurohet mbështetja e organizmave të ndryshme ndërkombëtare për realizimin e programeve dhe masave të zhvillimit.

Për këtë qëllim duhet të hartohen dhe përpunohen edhe për Shqipërinë konceptet e zhvillimit rajonal, të cilët duhet të përfshijë të tre nivelet:

- **Kombëtar**, të cilat paraqesin kornizat për hartimin e programeve rajonale dhe lokale.
- **Rajonal**, të cilat përfshijnë një hapësirë apo rajon të përcaktuar politikisht dhe që drejtohet nga një institucion zhvillimi me kompetenca të qarta vendimmarrëse.
- **Lokal**, të cilat bazohen në zhvillimet e nivelit bashkiak apo komunal.

## 2.6 Shqipëria turistike

Si një vend mesdhetar, Shqipëria ofron potenciale shumë të rëndësishme në fushën e turizmit. Këto potenciale shprehen si në pasuritë natyrore, ashtu edhe në historinë dhe kulturën e vendit tonë. Deri më sot këto potenciale nuk janë përdorur siç duhet në shërbim të turizmit, por përbëjnë një mundësi shumë të mirë zhvillimi në të ardhmen.

### Potencialet turistike natyrore

Ndër potencialet më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit në Shqipëri veçohet në radhë të parë **pozita e favorshme gjeografike** që zë vendi. Pikërisht dalja e tij e gjerë në detet Adriatik dhe Jon mundëson ekzistencën e një vije bregdetare me rreth 400 km gjatësi, ku ndërthuren lloje të ndryshme plazhesh ranore dhe zallore. Falë pozitës së saj gjeografike në Evropën Juglindore dhe si pjesë e Mesdheut, Shqipëria cilësohet si një vend turistik lehtësisht i arritshëm. Një potencial të rëndësishëm natyror për zhvillimin e turizmit në Shqipëri përbën edhe **relievi** me format e tij të shumëllojshme dhe peizazhet e bukura që ai krijon për syrin e turistit.



*Pamje nga Alpet e Shqipërisë*

Këto forma të larmishme të relievit krijojnë edhe dukuri shumë interesante natyrore me interes për t'u vizituar nga turistët, siç janë: shpellat karstike, cirqet akullnajore, kanionet lumore, ujëvarat etj. Gjithashtu **klîma** e Shqipërisë përbën një faktor shumë të rëndësishëm natyror për zhvillimin turistik. Mbizotërimi i klimës tipike mesdhetare në brigjet detare dhe me ndikim kontinental drejt lindjes dhe veriut, mundëson zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit në të gjitha stinët e vitit.

**Pasuritë e shumta ujore** përbëjnë një nga potencialet natyrore më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit. Këto pasuri ujore shprehen si në ekzistencën e dy deteve, ashtu edhe në ekzistencën e shumë liqeneve, lumenjve, burimeve natyrore etj. Të gjitha këto së bashku krijojnë peizazhe shumë të bukura dhe kushte tepër të përshtatshme për zhvillimin e llojeve të ndryshme të turizmit ujqor.

Bukurisë së formave të relievit, klimës së përshtatshme, pasurive të shumta ujore u shtohet edhe **bota e pasur bimore dhe shtazore**. E gjithë pasuria bimore krijon peizazhe shumë të bukura dhe tërheq pasionantë të shumtë të natyrës. Ekzistojnë një sërë parqesh kombëtare, të cilat përbëjnë potenciale të rëndësishme ekologjike që mund të shfrytëzohen mjaft mirë edhe në fushën e turizmit. Në brendësi të kësaj pasurie bimore, klimaterike dhe ujore rritet edhe një botë e pasur shtazore, e shprehur në lloje të ndryshme kafshësh e shpendësh, të cilat përbëjnë gjithashtu një potencial të rëndësishëm natyror edhe për zhvillimin e llojeve të veçanta të lëvizjes turistike, siç është ekoturizmi, turizmi për gjueti etj.

## 2.7 Potencialet turistike kulturore

Krahas atyre natyrore, Shqipëria përmban edhe shumë potenciale historike dhe kulturore për zhvillimin e turizmit.



*Pamje nga Butrinti*



*Pamje nga Berati*

Në to përfshihen:

- vendet dhe objektet arkeologjike (Butrinti, Apollonia, Dyrrahu etj.);
- kalatë dhe kështjellat mesjetare (Rozafa, Kruja, Berati, Tepelena, Gjirokastra etj.);
- objekte të ndryshme të kultit, si: kisha, xhami, teqe etj.;
- objekte të kulturës materiale dhe etnografike (veshjet, traditat, zakonet etj.);
- institucionet e ndryshme kulturore, si ato muzeale, teatrore, sportive etj, të cilat mund t'i shërbejnë shumë mirë edhe sektorit turistik.


## 2.8 Ecuria e zhvillimit të turizmit

Një sërë treguesish për përmasat, kapacitetet, strategjitë dhe drejtimet, pasqyrojnë ecurinë e zhvillimit të turizmit në Shqipëri dhe mbi këtë bazë edhe prirjet e tij për të ardhmen.

Deri në vitin 1990 turizmi në Shqipëri nuk përbënte përparësi dhe ishte shumë pak i zhvilluar. Situata do të ndryshonte me hapjen e vendit pas vitit 1990 e në vazhdim. Kështu, me fillimin e viteve '90 është vërejtur rritje e ndjeshme e numrit të turistëve vendas dhe të huaj, duke

arritur vitet e fundit në mbi 6 milionë. Bashkë me rritjen e numrit të turistëve janë shtuar dhe zgjeruar kapacitetet mbajtëse, ku sot numërohen mbi 300 hotele me 3-5 yje dhe shumë mundësi të tjera strehimi. Përmirësime të dukshme ka pasur edhe infrastruktura turistike, me rrugët, qendrat e pushimit, të argëtimit, sportit etj. Të gjitha këto kanë çuar në rritjen e të ardhurave që siguron vendi nga turizmi. Vitet e fundit këto të ardhura kanë arritur deri në mbi 1.5 miliardë euro në vit, duke e bërë kështu turizmin njërin ndër veprimtaritë kryesore në zhvillimin ekonomik të vendit.

Fig. 3: Të ardhurat nga turizmi në Shqipëri



Këto zhvillime kanë zgjeruar edhe llojet e mundshme të lëvizjes turistike në Shqipëri. Krahas turizmit për banjat diellore në brigjet detare dhe liqenore të vendit, rëndësi ka marrë edhe turizmi në male, vizita e shumë qendrave arkeologjike dhe muzeale, agroturizmi, turizmi i aventurës etj. Kjo jo vetëm që ka shtuar numrin e turistëve pjesëmarrës, por edhe ka zgjeruar dukshëm hartën turistike të Shqipërisë. Gjithashtu në rëndësi të veçantë ka marrë vitet e fundit edhe kombinimi i itinerareve turistike me vendet fqinje, duke i dhënë turizmit tonë përmasa rajonale dhe evropiane. Rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan turizmi ndërshqiptar në rajon në kuadër të atij që quhet “turizëm etnik”. Kjo ka bërë që numri më i madh i turistëve të ardhur në Shqipëri të jenë po shqiptarë nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, por dhe shumë shqiptarë që tashmë jetojnë jashtë vendit.

## 2.9 E ardhmja e zhvillimit turistik

Potencialet shumë të rëndësishme turistike që ka vendi, si dhe zhvillimet e derisotme, premtojnë për një zhvillim edhe më të madh të turizmit në Shqipëri në të ardhmen. Ndërkohë që një gjë e tillë kërkon fillimisht zgjidhjen e shumë problemeve që hasen për një zhvillim më të mirë të tij. Kjo lidhet në radhë të parë me përmirësimet e mëtejshme të infrastrukturës turistike, por edhe me përgatitjen e personelit të nevojshëm që t’i shërbejë sa më mirë sektorit, përmirësimin e imazhit turistik të Shqipërisë, investimet e qëndrueshme në këtë sektor etj.

Zgjidhja e këtyre problemeve do të krijonte kushtet e nevojshme për zhvillimin e duhur turistik të vendit. Qëllimi kryesor për zhvillimin e ardhshëm të turizmit shqiptar mbetet zbatimi i një turizmi modern e bashkëkohor, si dhe bashkërendimi më i mirë në zhvillimin e turizmit si me trevat e tjera shqiptare, ashtu edhe me vendet e ndryshme të Mesdheut dhe të gjithë rajonit.

## Tema mësimore nr.3: Rajoni Verior dhe Verilindor

### **3.1 Pozita gjeografike dhe përbërja e Rajonit Verior e Verilindor**

Rajoni Verior e Verilindor është rajoni më i madh në Shqipëri. Ai shtrihet në pjesën më veriore të Shqipërisë dhe shkon në jug deri në rrjedhën e mesme të lumit Shkumbin. Në veriperëndim kufizohet me Malin e Zi, ndërsa në veri-lindje me Kosovën dhe Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në perëndim kufizohet me rajonin Perëndimor. Ky rajon ndahet në dy nënjësi: Nënrajonin verior (Alpet Shqiptare) dhe nënrajonin Verilindor.

### **3.2 Nënrajonin Verior (Alpet Shqiptare)**

Alpet Shqiptare përfshijnë pjesën veriore të vendit dhe shtrihen në veri të lumit Drin. Me Nënrajonin Verilindor ndahen nëpërmjet gropës së Tropojës. Ato zënë 8% të vendit. Alpet Shqiptare kanë pozitë gjeografike tepër të izoluar, sepse rrugët që i lidhin ato me rajonet e tjera brënda dhe jashtë vendit janë të pakta dhe në gjëndje jo të mirë.

#### **3.3 Ndërtimi gjeologjik.**

Alpet kanë ndërtim gjeologjik të larmishëm, që ka ndikuar në modelimin e relievit të ashpër e të copëtuar. Përhapjen më të madhe e kanë gëlqerorët, me të cilët lidhen majat dhe kreshtat alpine, format karstike dhe minerali i boksitëve. Depozitime terrigjene, të vjetra (rreshpe të pasura me kuarcite) dhe te reja (flish), me të cilat lidhen relieve më të buta dhe te copëtuar nga rrjedhjet ujore. Në verilindje ka magmatikë të fortë, me të cilat lidhet relievi i ashpër.

#### **3.4 Relievi.**

Alpet përbëjnë grumbullin malor me relievin më të ashpër e më të copëtuar në Shqipëri, që lidhet me shkëputjet tektonike dhe lëvizjet diferencuese, me veprimin e karstit, akujve dhe borës. Lartësia mesatare e alpeve arrin deri në 1500 m, kurse lartësia maksimale arrin 2694 m (maja e Jezercës), e dyta në vend, mbas majës së Korabit. Relievi i Alpeve ka trajtën e kupolës. Në pjesën qendrore të kupolës zënë fill luginat e mëdha dhe kurrizet malore, të cilat duke u ulur, shpërndahen në formën e rrezeve drejt rrethinave.

#### **3.5 Klima malore (alpine)**

Klima malore alpine ka verë të freskët dhe dimër të gjatë, të ashpër, me ngrica dhe rreshje të shumta. Temperatura ulet nga rrethina drejt qendrës. Në dimër temperatura zbret shpesh në -15 gradë celsius. Për shkak të relievit malor, bien më shumë rreshje se kudo në Shqipëri, pjesa më e madhe në formën e dëborës, me shtresë deri në 2-3 m, me të cilën lidhen ortekët.

#### **3.6 Hidrografi alpine**

Rajoni ka pasuri të mëdha ujore. Lumenjtë e shumtë kanë rrjedhje të shpejtë, ujë të bollshëm dhe të ftohtë. Me furnizim kryesisht nga shkërrja e dëborës, lidhen prurjet maksimale në pranverë. Lumenjtë kryesorë janë Valbona, Shala, Curraj-Nikaj, Cemi, Kiri, etj. Ndodhen rreth 30 liqene akullnajore, si liqenet e Gashit, Jezercës, etj.

#### **3.7 Tokat**

Tokat janë kryesisht të murrme pyjore dhe të kafenjta, më pjellore në lugina dhe me të varfra në shpatet e maleve.

#### **3.8 Bimësia dhe bota shtazore**

Bimësi dhe botë shtazore e pasur, me gjallesa të shumta endemike, lidhet me relievin e thyer, mozaikun klimatik, pasurinë e tokave. Bimësia përbëhet nga dushqe, ahishte, halorë dhe kullota alpine. Ndër kafshët e egra dallohen ariu i murrmë, macja, rrëqebulli, derri e dhia e egër, kunadhja, shqiponja, etj.

#### **3.9 Njësitë përbërëse të Alpeve Shqiptare**

**Bloku i jezercës.** Shtrihet në qëndër të Alpeve, dhe rrethohet nga gropa, lugje e lugina të thella. **Malësia e Madhe**, në veriperëndim të Alpeve, përbëhet nga kurrize malore dhe blloqe të larta, si Bjeshkët e Namuna, pllaja karstike (Veleçik – Bridashë), dhe disa lugina, si ajo e Cemit, Përroit të Thatë).

**Lugina e Shalës**, ndër më të mëdhatë në Alpet shqiptare, përbëhet nga gropa e madhe e Thethit 760-800 m mbi nivelin e detit.

**Kurrizi Toplanë –Maja e Boshit dhe Mërtur Zhabore** shtrihen midis luginës së Valbonës dhe të Shalës dhe ndahen nga lugina e Currajt.

**Lugina e Valbonës** në pjesën e sipërme ka formën e një govate të madhe të modeluar nga akujt e katërsorit.

**Malësia e Gashit**, e përbërë nga magmatikë, dallohet për relievin e ashpër, me forma më të shumta të ruajtura akullnajore, ku ka liqene akullnajore, pyje e kullota të pasura.

### **3.10 Vlerat dhe ofertat e natyrës së Alpeve.**

Alpet ofrojnë pasuri të mëdha natyrore, si: larmi të theksuar, trashëgimi natyrore, pasuri të shumta ujore me rezerva hidroenergjetike, pyje e pasuri floristike, minerale metalike e jometalike, bukuri mahnitëse të peisazhit. Ato mundësojnë zhvillimin e turizmit të gjelbër dhe të bardhë, të ekonomisë pyjore, blegtorisë dhe bletarisë, sigurojnë burime të mëdha të energjisë së pastër.

### **3.11 Nënrajonit Verilindor dhe pjesët përbërëse**

Ky nënrajon përfshin zonat malore që shtrihen nga rrjedha e poshtme e lumit të Valbonës dhe kufiri shtetëror me Kosovën deri në luginën e Shkumbinit të mesëm. Shtrirja shumë e madhe veri-jug kushtëzon larinë e natyrës, popullimit dhe ekonomisë. Ndaj në këtë nënrajon dallohen disa pjesë përbërëse të cilat janë: Malësia e Hasit dhe e Gjakovës, Malësia e Pukës dhe e Mirditës dhe vargjet malore të Lurës; Malësia e Martaneshit, Gollobordës dhe e Cermenikës; Lugina e Drinit të Zi dhe Vargu i Korabit; lugina e Matit dhe vargjet e Skënderbeut.

### **3.12 Popullimi i Alpeve Shqiptare**

Popullimi i rajonit u përcaktua nga kushtet natyrore, në përgjithësi të vështira dhe nga zhvillimet politike, ekonomike, historike, sociale të vendit dhe jashtë tij. Kjo kushtëzoi numrin më të vogël të popullsisë, rritjen dhe zvoglimin në periudha të caktuara, shpërndarjen gjeografike dhe tiparet e veçanta të saj. Alpet dallohen për popullim të pakët. Popullsia e tyre zë 2% të popullsisë së Shqipërisë.

### **3.13 Trashëgimia natyrore dhe kulturore, pasuri e rëndësishme për zhvillimin e rajonit Verior e Verilindor**

Zonat e mbrojtura dhe monumentet kulturore të rajonit Verior e Verilindor ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit dhe ekonomisë së këtij rajoni. Dallohen qendrat turistike si: Thethi, Valbona, Razma, Dajti, monumentet e natyrës etj.

### **3.14 Braktisja masive e rajonit Verior e Verilindor, pas vitit 1990**

Rajoni Verior e Verilindor njohu migrime masive të popullsisë pas vitit 1990, kur u la e lirë lëvizja e popullsisë. Shkaqet e migrimit masiv janë të shumta: natyrore, ekonomike, sociale etj. Kjo u shoqërua me pasoja të shumta si për rajonet që humbasin popullsinë, por edhe për rajonin pritës siç ishte ai perëndimor. U zvoglua vazhdimisht numri i popullsisë, rrënimi dhe braktisja e shumë qendrave rurale madje dhe disa urbane, braktisja e tokës së punëshme që favorizon degradimin, etj. Edhe në të ardhmen do të vazhdojë largimi i popullsisë nga rajoni.

### **3.15 Kushtet e zhvillimit ekonomik të rajonit verior e verilindor**

Rajoni Verior e Verilindor i Shqipërisë konsiderohet rajoni më pak i zhvilluar ekonomikisht në krahasim me rajonet e tjera të vendit. Në këte rajon ekziston një kontraditë midis pasurive shumë të mëdha natyrore dhe nivelit të ulët të zhvillimit dhe mirëqënies.

Ndër potencialet natyrore theksojmë: Pasuritë e mëdha mbi dhe nëntokësore, ofertë shumë e pasur turistike, pozitë e favorshme gjeografike. Të gjitha këto pasuri natyrore përbëjnë potenciale shumë të favorshme për zhvillimin ekonomik të rajonit në drejtim industrial dhe turistik

### **3.16 Vështirësi- potenciale humane tepër të kufizuara për zhvillimin e rajonit**

Për zhvillimin e rajonit nuk mjaftojnë vetëm pasuritë natyrore. Ky zhvillim kërkon edhe resurse njerzore, trashëgimi dhe tradita urbane dhe të menaxhimit socio-ekonomik. Rajoni për shkak të migrimit masiv të popullsisë, po përballet me pakësimin e madh të resurseve njerzore, të afta për punë dhe me zvoglimin e konsumit të produkteve qarkullimin e tregtisë dhe shërbimeve.

### **3.17 Mundësi dhe perspektiva të zhvillimit të rajonit Verior e Verilindor**

Janë të gjithë mundësitë që rajoni Verior e Verilindor të zhvillohet me ritme të shpejta dhe në mënyrë të qëndrueshme. Përparësi duhet të marrë turizmi, pa lënë në harresë dhe degë të tjera të ekonomisë. Industria të bazohet në resurset natyrore, mund të zhvillohen degë të saj si industria energjitike, sidomos ajo elektrike. Industria minerale duhet të përbëjë në të ardhmen degë të rëndësishme të ekonomisë së rajonit. Krahas tyre mund të zhvillohet industria e druritmbështetur në ekonominë pyjore të zhvilluar dhe të kontrolluar, industria agroushqimore për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale. Artizanati me tradita në përpunimin e gurit, drurit, metaleve, leshit dhe prodhimin e suvenireve për turistët.

### **3.18 Turizmi**

Turizmi duhet të jetë dega më e zhvilluar e sektorit të tretë dhe e gjithë ekonomisë së rajonit. Duke u mbështetur në trashëgiminë e pasur natyrore dhe kulturore, në traditat e pasura shpirtërore, të mikëpritjes dhe kulinarisë, në integrimin në rajonet fqinje, falë pozitës nje gjeografike, turizmi duhet të marrë përparësi. Janë kushtet për aplikimin e disa llojeve të turizmit si blu, i gjelbër, malor, kurativ, kulturor etj.

### **3.19 Bujqësia**

Bujqësia e specializuar në prodhimet bujqësore dhe blegtorale organike, të vëna në dispozicion të turizmit, nëpërmjet agropërpunimit dhe kulinarisë tradicionale të rajonit.

### **3.20 Zhvillimi i rajonit në raport me rajonet e tjera të vendit**

Zhvillimi i këtyre degëve me përparësi turizmin, do të frenojë shpopullimin e rajonit. Zhvillimi i rajonit Verior -Verilindor do të sjellë, jo vetëm, efekte pozitive për rajonin, por edhe për rajonet e tjera të vendit. Do të lehtësonte rajonin Perëndimor nga përqëndrimi i madh i popullsisë, do të krijonte mundësi për investime dhe punësim edhe për rajonet e tjera.

## **Tema mësimore nr.4: Rajoni Juglindor**

### **4.1 Pozita gjeografike dhe rëndësia ndërkufitare e tij për zhvillimin rajonal**

Ky rajon shtrihet në juglindje të vendit, nga lugina e Shkumbinit të mesëm e lugina e lumit të Qarrishtës dhe duke përfshirë gropa, fushëgropa, lugina, male, vargje malore dhe malësi, mbërrin deri në Leskovik. Në Perëndim kufiri ndjek lumin e Devollit dhe lumin e Osunit. Pozita gjeografike ka një rëndësi të madhe gjeo-ekonomike, gjeopolitike, gjeostrategjike sepse me anë të pikave kufitare, si: Qafa e Thanës, Tushemishti dhe Gorica, lidhet me Republikën e

Maqedonisë së Veriut, ndërsa me anë të Kapshticës dhe Tri Urave lidhet me Greqinë.

#### **4.2 Kushtet natyrore**

Natyra e rajonit është shumë e larmishme. Ndërtimi gjeologjik i ndërlikuar, përbëhet nga shkëmbinj sedimentar (terrigjenë), që ndodhen në gropa dhe fushëgropa; shkëmbinj gëlqeror, që përbejnë malësitë dhe vargjet malore; dhe shkëmbinj të magmatik, të cilët janë më pak të përhapur. Rajoni përshkohet nga thyerje të mëdha aktive tektonike, ndaj janë të shpeshta tërmetet. Rajoni është shumë i pasur me minerale, si; hekur-nikel, nikel silikat, bakër, azbest, talk, serpentinë, etj në shkëmbinj magmatik të pasur me qymyrguri, rëra kuarcore, argjila, dolomite dhe mermerë në shkëmbinj sedimentarë.

#### **4.3 Relievi**

Relievi është i larmishëm, tepër i çrregullt shumë i copëtuar dhe me kontraste të mëdha. Ai përbëhet nga gropa, fushëgropa, lugina, malësi, kurrize, vargje dhe blloqe malore, të cilat, ndërthuren dhe ndërpresin njera-tjetrën, duke formuar një mozaik formash. Në krahasim me rajonin Verior në këtë rajon kanë shtrirje sipërfaqet e sheshta apo me pjerrësi të vogël në luginat, gropat dhe sidomos në fushëgropa.

#### **4.4 Klima**

Klima dallohet për ndikim të dukshëm kontinental, që shprehet në dimrin e ashpër dhe me ngrica, vera në pjesën më të madhe të rajonit është e freskët. Dallohet për vlera shumë të ulta skajore deri në -26.9 gradë në Sheqeras, në veri të fushëgropës së Korçës. Në gropa e fushëgropa bien më pak rreshje. Dëbora bie në gjithë rajonin.

#### **4.5 Hidrografia**

Hidrografia në krahasim me rajonet e tjera është më e varfër në lumenj të mëdhenj, ndër të cilët më kryesorët janë rrjedha e sipërme e Shkumbinit, e Devollit dhe të disa degëve të djathta të Vjosës. Rajoni është i pasur me liqene të mëdha si Ohri dhe Prespa me rëndësi ekonomike, ekologjike dhe turistike etj, si dhe disa liqene akullnajore (Valamarë, Shebenik etj.) Rajoni është i pasur me burime dhe ujra nëntokësorë. Dallohet fushëgropa e Korçës e pasur me ujra arteziane.

**4.6 Tokat** janë të llojeve të ndryshme. Mbizotërojnë tokat e kafenjta dhe të murrme pyjore ndërsa në lartësitë mbi 1600 m takohen tokat livadhore malore.

**4.7 Bota bimore dhe shtazore** është shumë e larmishme. Në këtë rajon ndërthuren lloje bimësh të trevave veriore me ato të trevave jugore dhe mesdhetare. Bimësia përbëhet nga dushqet, shkurret mesdhetare, nga ahishte dhe halorë. Edhe bota shtazore është e larmishme. Takohen arriu i murrmë, rrëqebulli etj.

#### **4.8 Pjesët përbërëse të rajonit juglindor dhe trashëgimia natyrore**

Dy vargjet kryesore malore ai Perëndimor (mali i Polisit, i Shpatit, i Gurit të Zi, Gurit të Topit dhe të Valamarës, malësia e Vithkuqit dhe e Kolonjës) dhe ai Lindor (mali i Shebenikut, Mali i Thatë, mali i Moraves dhe i Gramozit)

Gropat dhe fushgropat si fushgropa e Korçës, e Përrenjasit, e Pogradecit, e Prespës së Madhe.

Gropa e Kolonjës, lugina e Shkumbinit të Sipërm, lugina e Devollit të Sipërm.

#### **4.9 Natyrë komplekse me trashëgimi të pasur natyrore**

Për shkak të natyrës komplekse rajoni dallohet për trashëgimi të pasur natyrore. Cilësohen si trashëgimi natyrore botërore liqeni i Ohrit, rezerva ndërkufitare e Biosferës Ohër- Prespë, Ligatina Ramsar e liqeneve të Prespave, Parku Kombëtar i Prespës, Bredhi i Drenovës, dhe Parku Shebenik –Jablanicë.

#### **4.10 Zhvillimi demografik i rajonit dhe trashëgimia kulturore**



Ky rajon dallohet për shtim të vogël të popullsisë që lidhet me numrin më të pakët të lindjeve dhe sidomos me migrimet e shumta veçantërisht jashtë shtetit. Popullsia ka shpërndarje gjeografike të pabarabartë. Dëndësia mesatare e popullsisë së rajonit është me e vogla se mesatarja e vendit. Në këtë rajon mbizotëron popullsia fshatare. Pas viteve 90 u shtuan ritmet e lëvizjes së popullsisë fshatare drejt qyteteve. Për shkak të emigrimit dhe rënies së lindjeve po vihet re plakja e popullsisë. Popullsia ka tradita të pasura kulturore. Vendbanimet më të shumta janë në fushëgropat, në gropën e Pogradecit dhe në luginën e Devollit të Sipërm.

#### **4.11 Trashëgimia natyrore dhe kulturore pasuri e rëndësishme për zhvillimin e rajonit Juglindor**

Zonat e mbrojtura dhe monumentet e shumta kulturore të rajonit Juglindor ofrojnë mundësi të shumta për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit. Dallohen qendra turistike si Pogradeci, Korça, Voskopoja, Dardha, parqet kombëtare, monumentet e natyrës etj.

#### **4.12 Potencialet dhe gjendja e zhvillimit ekonomik të rajonit**

Rajoni Juglindor zë një nga vendet kryesore në prodhimin bujqësor në vend. Dega kryesore është bujqësia. Pjesa më e madhe e tokave të punueshme është e mbjellë me bimë të arave, veçantërisht me drithëra. Vend të vecantë zë dhe kultivimi i perimeve, patateve dhe fasuleve. Blegtoria po merr gjithmonë e më tepër përparësi pasi dhe kërkesat e tregut për prodhime blegtorale janë rritur.

Rajoni ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e industrisë, të cilat lidhen me pasuritë e shumta natyrore të vendit, me mundësitë e lidhjeve brenda dhe jashtë vendit, me fuqinë puntore të kualifikuar, me tradita e pasura, etj. Ky rajon dallohet për zhvillimin e disa degëve të industrisë si ajo energjitike, minerale, e materialeve të ndërtimit, drurit, ushqimore, veshjeve etj. Artizanati ka tradita të lashta në përpunimin e leshit, gurit, drurit, metaleve etj.

**4.13 Turizmi** ka marrë zhvillim të mirë, janë të njohura qendrat turistike si: Pogradeci, Korça, Voskopoja, Dardha. Në këtë rajon mund të zhvillohet turizmi blu në brigjet e liqenit të Ohrit, Prespës së madhe, turizmi qytetar e kulturor në qytetet me tradita të pasura arkitektonike dhe objekte të shumta arkeologjike, historike etj. Turizmi i gjelbër në zonat fshatare, që kanë traditë të pasur të mikpritjes dhe nivel të mirë kulturor të popullsisë. Turizëm malor në lartësitë e maleve të Shebenikut, Valamarës, Gramozit, etj me natyrë të pastër, shumë të bukur, të mbushur me monumente natyrore. Rajoni ka traditë rrëshqitjen me ski sidomos në Voskopoje dhe në Dardhë, që janë bazë për inicimin e zhvillimit të turizmit të bardhë.

#### **Mundësitë dhe perspektivat e zhvillimit të rajonit Juglindor**

Politikat dhe strategjitë e reja për shfrytëzimin efektiv dhe për integrimin e rajonit me rajonet brënda e jashtë vendit krijojnë mundësi që të përcaktohen drejtimet e duhura ekonomike për zhvillimin e shpejtë e të qëndrueshëm të rajonit. Ndër degët kryesore të konomisë që mund të zhvillohen në të ardhmen në rajon janë: Bujqësia, ekonomia pyjore, peshkimi, apikultura, etj.

Turizmi duhet të jetë dega më e zhvilluar e ekonomisë. Duke u mbështetur në trashëgiminë e pasur natyrore dhe kulturore, në nivelin e lartë kulturor të popullsisë turizmi duhet zhvilluar më tepër.

## **Tema mësimore nr.5 Rajoni Jugor**

### **5.1 Pozita gjeografike**

Rajoni Jugor përfshin gjithë pjesën jugore të vendit dhe ka dalje të gjërë në detin Jon. Shtrirja e tij veri-jug është 120 km dhe lindje-perëndim 115 km. Pozita gjeografike e rajonit kushtëzon

tiparet mesdhetare të peizazhit, sidomos të klimës, hidrografisë, botës bimore e shtazore. Në të njëjtën kohë kjo pozitë është e favorshme edhe për zhvillimin ekonomik. Kjo është e lidhur me krijimin e kushteve për zhvillimin e turizmit. Njëherazi rajoni që në antikitet është përshkruar nga rrugë të rëndësishme, që e lidhin atë me trevat e tjera , Greqinë dhe me portet e detit Egje.

### **5.2 Kushtet natyrore**

Rajoni jugor është kryesisht rajon malor, por ka natyrë, sidomos ndërtim gjeologjik dhe reliev më të thjeshtë se rajonet e tjere malore të vendit. Rajoni përbëhet kryesisht nga gëlqeror dhe terrigjenë.

Relievi shtrihet nga niveli i detit deri në 2465 m (Nëmërçkë). Mbizotërojnë lartësitë deri 800 m mbi nivelin e detit. Në përbërje të relievit dallohen vargje malore, malësi, lugina, dhe fushëgropa e Delvinës. Njësitë e relievit lidhen midis tyre me gryka të ngushta dhe qafa, nëper të cilat kalojnë rrugë automobilistike.

### **5.3 Klima**

Klima është tipike mesdhetare me dimër më të butë dhe më të lagësht dhe me verë më të nxehtë e më të thatë se në rajonete tjera malore të vendit. Më shumë rreshje bien në zonën e Kurveleshit. Rreshjet e dëborës kanë rastijsje të rrallë në rivierë dhe në fushëgropën e Delvinës.

### **5.4 Hidrografia**

Hidrografia është mjaft e pasur dhe përbëhet;lumenjtë Vjosë me dy degë Drinos dhe Shushicë, lumin e Osumit, Kalasë, Bisticë e Pavllë. Ata dallohen për regjim të shprehur mesdhetar dhe resurse të mëdha hidroenergjitike. Liqeni i kripur i Butrinit lidhet me detin nëpërmjet kanalit të Vivarit.

### **5.5 Tokat**

Tokat janë kryesisht të kafenjta dhe të hirta kafe, pjellore në lugina dhe në fushëgropën e Delvinës dhe të varfëra në shpatet e kodrave dhe maleve.

**5.6 Flora dhe fauna** janë të larmishme. Dominojnë elementet mesdhetare, ndërsa në lartësi shfaqen dhe elemente të trevave veriore shqiptare dhe ballkanike. Bimësia përfaqësohet nga shkurret mesdhetare me gjelbërim të përhershëm. Shtrirjen më të madhe e kanë dushqet. Në faunën e rajonit dallohen dallohen gjitarët si ariu, kaprolli , derri i egër etj.

### **5.7 Njësitë përbërëse**

Njësitë përbërëse të rajonit jugor janë; Malësia midis Tomorrit dhe Melesinit; vargjet malore midis Vjosës së Sipërme dhe Drinos, Malësia e Kurveleshit dhe Vargu Mali i Gjerë –Stugarë, Malet Bregdetare.

Luginat dhe fushëgropa e Delvinës; Lugina e Vjosës, Lugina e Drinos, lugina e Shushicës dhe Fushëgropa e Delvinës.

### **5.8 Trashëgimia natyrore**

Për shkak të natyrës së larmishme dhe pozicionit më jugor gjeografik, rajoni ka trashëgimi të pasur natyrore.Trashëgimia natyrore kombëtare përbëhet nga Rezervati strikt i mbrojtur i Kardhiqit, Parku Kombëtar i Llogarasë, Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli, Parku Kombëtar i Tomorrit, Parku Kombëtar i Butrintit, Parku Kombëtar Detar Sazan- Karaburun.

### **5.9 Zhvillimi demografik i rajonit dhe trashëgimia kulturore**

Për shkak të emigrimit dhe rënies së lindjeve po shfaqet plakja e popullsisë. Mbizotëron popullsia qytetare e cila zë mbi 53% të popullsisë së përgjithshme të rajonit. Shtimi natyror i popullsisë qytetare është i ulët. Rritja e saj lidhet më shumë me ardhjet nga zonat fshatare.Vendbanimet fshatare janë më të shumta në fushëgropën e Delvinës dhe në lugina.

Ka gjithsej rreth 14 vendbanime qytetare si; Gjirokastra, Përmeti, Delvina, Corovoda, etj. Pasuria e madhe e trashëgimisë kulturore lidhet me popullimin e lashte dhe zhvillimin social,ekonomik e

kulturor. Dallohen sítet e trashëgimisë botërore Butrinti dhe Gjirokastra. Trashëgimia kulturore kombëtare është shumë e pasur dhe e larmishme. Dallohen qytetet antike ilire si Antigona, Foinikes, Amantia etj.

### **5.10 Struktura ekonomike e rajonit**

Rajoni ka një mjedis të përshtatshëm për bujqësi dhe blegtori në luginat dhe fushëgropën e Delvinës. Bujqësia është dega më e rëndësishme e rajonit. Sipërfaqet e sheshta dhe klima më e ngrohtë e këtij rajoni e favorizojnë atë. Rajoni ka dhe kushte për zhvillimin e industrisë. Këto kushte lidhen me pasuritë natyrore, me mundësitë e lidhjeve brenda e jashte vendit, me fuqine puntore të kualifikuar etj. Janë zhvilluar këto degë të industrisë si: industria energjitike, minerare, industria e materialeve të ndërtimit, industria ushqimore, e lehtë etj. Artizanati ka traditë të lashtë në përpunimin e leshit, gurit drurit etj. Turizmi është dega më e zhvilluar e rajonit. Kjo lidhet me kushtet shumë të mira të zhvillimit të disa llojeve të turizmit si blu, qytetar, të gjelbër, malor dhe fetar. Me zhvillimin e turizmit lidhet profilizimi turistik i disa qendrave të banuara qytetare (Saranda, Gjirokastra) dhe rurale sidomos në Rivierë, nxitja e zhvillimit të disa sektorëve të tjerë të ekonomisë si blegtoria, prodhimi i perimeve frutave, industria agrourbushqimore, artizanati dhe diferencimi i rajonit në dy nënrajone

### **5.11 Ekonomia e rajonit në rrugën e integritit ndërrajonal**

Struktura ekonomike e rajonit, sidomos zhvillimi i dukshëm i Turizmit dhe lidhjet me rrugë të rëndësishme automobilistike dhe detare me rajonet e tjera të vendit dhe Greqinë, ndikojnë në integritimin ndërrajonal brenda dhe jashte vendit.

### **5.12 Mundësitë dhe perspektiva e zhvillimit të rajonit Jugor**

Rajoni jugor ka resurse natyrore si pozita e privilegjuar gjeografike, ndertimi gjeologjik, relievi, pasuritë klimatike, ujore, të tokave, flores e faunes, trashëgimia natyrore dhe kulturore, si dhe resurse njerzore (numri i konsiderueshëm dhe struktura e popullsisë). Këto kanë qënë të përshtatshëm për zhvillimin ekonomik dhe do krijojnë kushte për zhvillimin e shpejtë dhe të qëndrueshëm të rajonit.

### **5.13 Perspektiva e zhvillimit të rajonit jugor**

Ndër degët e ekonomisë që duhet të zhvillohen në të ardhmen janë; bujqësia e specializuar në agroturizëm, sidomos për tregun turistik. Turizmi është dhe duhet të jetë dega më e zhvilluar dhe prioritare e ekonomisë. Duke u mbështetur në trashëgiminë e pasur natyrore dhe kulturore, në nivelin e lartë kulturor të popullsisë, në traditat e pasura shpirtërore, të mikpritjes dhe kulinarisë mund të aplikohen disa lloje të turizmit si blu, qytetar, kulturor, i gjelbër, kurativ, fetar etj. Kjo do sigurojë shtrirjen e turizmit gjatë gjithë vitit. Industria duke synuar mbështetjen e sektorëve të tjerë ekonomikë dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, duhet të bazohet në rradhë të parë në resurset natyrore dhe në mundësitë konkurruese të saj. Në këto kushte duhet të zhvillohet industria energjitike, ajo e naftës dhe gazit natyror, industria agrourbushqimore etj.

## **Tema mësimore nr 6: Rajoni Perëndimor**

### **6.1 Pozita gjeografike**

Rajoni Perëndimor zë gjithë pjesën perëndimore të vendit, nga gjiri i Hotit dhe liqeni i Shkodrës (veri) deri në Vlorë (jug). Në perëndim laget nga deti Adriatik ndërsa në lindje arrin deri në rrëzën perëndimore të Alpeve Shqiptare dhe vargmaleve të rajoneve të tjera të vendit. Kjo pozitë gjeografike është shumë e përshtatshme për zhvillim sepse rajoni lidhet me rrugë automobilistike dhe hekurudhore me rajonet e tjera të vendit.

### **6.2 Ndërtimi gjeologjik dhe format e relievit**

Ndërtimi gjeologjik i rajonit është më i vonë se rajonet e tjera. Evolucioni i natyrës së rajonit vazhdon. Për shkak të depozitimeve të shumta të lumenjve, të cektësisë së detit, lëvizjeve ngritëse të pjesës më të madhe të zonës bregdetare, të lëkundjeve të vogla të baticës dhe zbatës, fushat e këtij rajoni vazhdojnë të rriten në drejtim të detit në disa sektore, dhe në disa të tjerë përparon deti në drejtim të fushave. Si rrjedhim i këtij evolucioni ky rajon përbëhet tërësisht nga terrigjen, dhe shumë pak nga gëlqeror dhe gipse. Relievi përbëhet nga fusha dhe kodra.

### **6.3 Klima dhe pasuritë ujore**

Klima është e ngrohtë sepse relievi është fushor- kodrinor, laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Ka verë të nxehtë dhe të thatë, ndërsa dimri është i butë dhe i lagësht. Hidrografia është shumë e pasur me rrjedhjet e poshtme të lumenjve më të mëdhenj të vendit, liqene të ëmbla dhe të kripura si dhe ujra nëntoksore. Kjo pasuri e madhe ka rëndësi të madhe ekonomike.

### **6.4 Tokat dhe pasuria bimore**

Tokat përbehen nga toka të hirta kafe. Bimësia natyrore ka shtrirje të kufizuar sepse është zëvendësuar me bimë të kultivuara.

### **6.5 Njësitë përbërëse**

Njësitë kryesore të rajonit perëndimore janë: Ultësira Perëndimore, fusha midis Lezhës dhe Shkumbinit, kodrat e Krrabës, fusha e Elbasanit, pllaja e Dumre- Darsisë, fusha e Myzeqesë dhe kodrat e Mallakastrës.

### **6.6 Pasuritë natyrore**

Peizazhi natyror i rajonit është transformuar shumë nga dora e njeriut. Për shkak të pozitës gjeografike, në kontaktin midis detit dhe tokës rajoni ka trashëgimi të pasur natyrore. Si parku kombëtar Divjakë –Karavasta, ai i Dajtit, liqeni i Shkodrës etj.

### **6.7 Karakteristikat kryesore të popullimit**

Ardhja e shumtë e popullsisë në rajonin perëndimor nëpërmjet procesit masiv të migrimit pas 1990 është shoqëruar me disa ndryshime të karakterit demografik dhe social. Kjo ka bërë që popullsia sot të karakterizohet nga mbizotërimi i moshave të reja në strukturën moshore të saj, nga shtimi i lartë natyror, nga përqindja më e lartë e popullsisë qytetare në këtë rajon në krahasim me të gjithë rajonet e tjera të vendit. Kështu mbi gjysma e popullsisë së rajonit banon në qendrat qytetare të tij. Faktorë të tillë si kushtet e mira gjeografike natyrore, gjëndja më e mirë ekonomike, mundësitë me të shumta të punësimit, infrastruktura më e zhvilluar, kanë stimuluar përherë ardhje të tilla. Përqendrimin më madh e ka qarku i Tiranës. Efektet e migrimit janë shoqëruar me një sërë efektesh negative dhe pozitive. Ky proces ka qënë përcaktues për ecurinë e shumë aspekteve ekonomike e sociale.

### **6.8 Kushtet e zhvillimit ekonomik të rajonit**

Rajoni Perëndimor cilësohet si rajoni më i zhvilluar ekonomikisht se cdo rajon tjetër në vendin tonë. Kjo lidhet me kushtet e favorshme natyrore, ashtu dhe me traditën e zhvillimit social dhe ekonomik. Rajoni zë një pozitë kyçe në kryqëzimin e rrugëve që lidhin si rajonet e brëndëshme dhe ato të jashtme me Shqipërinë. Këtë e mundëson prania e aeroportit dhe të disa porteve detare. Dominimi i relievit të butë fushor dhe i klimës mesdhetare dhe ujrave të shumta mundëson zhvillimin e bujqësisë dhe një sërë aktivitetesh të tjera.

Në këtë rajon është përqëndruar dhe 2/3 e gjithë popullsisë së vendit dhe kjo përbën gjithashtu një potencial human për rajonin.

### **6.9 Ecuria e zhvillimit ekonomik të vendit**

Ndryshimi i sistemit ekonomik mbas viteve 90 u shoqërua me ndryshime të të gjithë aktivitetëve prodhuese të vendit tonë. Pati një rënie totale të degëve të industrisë. U krye privatizimi i

ndërrmarrjeve të vogla të ekonomisë dhe u ringrit ekonomia. Zhvillim shumë të dukshëm pati ekonomia bujqësore, veçantërisht në zonat fushore. Sot rajoni mban peshën më të madhe të ekonomisë së gjithë vendit.

#### **6.10 Struktura e degëve të ekonomisë**

Ekonomia bujqësore mban peshën kryesore në ekonomin e rajonit. Rajoni Perëndimor nuk dallohet për pasuri nëntoksore me përjashtim të rezervave të naftës, gazit natyror, dhe qymyrit. Kanë qënë faktorë të tillë si fuqia puntore, afërsia me portet, transporti më i zhvilluar që kanë ndikuar në zhvillimin industrial të rajonit. Ndër degët kryesore të industrisë veçojmë: Energjistikën, industrinë e metalurgjisë së zezë, mekanike, kimike, industrinë e materialeve të ndërtimit, industrinë e lehtë dhe ushqimore.

#### **6.11 Sektori i tretë i ekonomisë**

Rëndësi gjithnjë e më të madhe për rajonin po merr sektori i tretë i ekonomisë që përfaqësohet nga transporti, turizmi, trgtia, shërbimet etj. Transporti paraqitet në të gjitha llojet e tij, tregtia një nga sektorët më të fuqishëm per momentin. Rrjeti kombëtar është i shpërndarë kudo në të gjithë qytetet më të rëndësishme si Tirana, Durrësi, Shkodra ,Vlora etj

#### **6.12 Turizmi**

Rajoni paraqet mundësi shumë të mira natyrore dhe kulturore. Rajoni ka dalje të gjërë në detin Adriatik me plazhe të shumta. Gjithashtu rajoni përmban dhe vlera të shumta historike dhe kulturore në shërbim të turizmit,si qëndra dhe objekte të shumta arkeologjike, kala, dhe kështella.

#### **6.13 Rëndësia e rajonit**

Rajoni do vazhdojë dhe në të ardhmen si rajoni më i zhvilluar ekonomik i vendit në të gjitha drejtimet. Rajoni do vazhdojë edhe rritjen e popullsisë. E rëndësishme është që këto potenciale të të menaxhohen mirë në shërbim të një zhvillimi të qëndrueshëm të rajonit. Rajoni është më tepër konsumues se prodhues i të mirave materiale . Pritet të rritet edhe më shumë roli i aktiviteteve të sektorit të tretë të ekonomisë si tregtia, turizmi, shërbimet etj.

### **Tema mësimore nr.7 Gjeografia e Ballkanit Perëndimor**

#### **7.1 Pozita gjeografike dhe rëndësia e saj**

Ballkani Perëndimor zë gjithë pjesën pranë adriatike të Gadishullit të Ballkanit, duke u shtrirë nga Greqia në jug e deri në Kroaci në veri. Pjesë e tij janë 6 shtete: Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnje-Herzegovina.

Me këtë shtrirje gjeografike vendet e Ballkanit Perëndimor gjenden në një pozicion ndërmjetës midis hapësirave ujore të Mesdheut dhe atyre kontinentale të Evropës. Me këtë pozicion ato shërbejnë si një urë lidhëse midis Evropës dhe Azisë. Prandaj historikisht në to janë ndërtuar rrugë shumë të rëndësishme që lidhin vende të shumta në Evropë dhe Azi. Kështu p.sh. që në periudhën e antikitetit rruga më rëndësishme tregtare e asaj kohe me emrin Egnatia kalonte përgjatë disa prej këtyre



*Harta e vendeve të Ballkanit Pëëndimor*

vendeve.

Në kohët moderne territori i tyre është bërë gjithnjë e më i rëndësishëm me pozicionin e tij për lidhjet midis vendeve të ndryshme. Kështu janë ndërtuar akse shuma ta rëndësishme rrugore në formën e autostradave siç është ajo Beogradë – Nish - Sofie - Stamboll, Kroaci - Mali i Zi - Shqipëri, Rruga jonë e Kombit etj.

Po kështu erdhi gjithmonë duke u rritur rëndësia e transportit detar, lumor, ajror etj. Janë ndërtuar shuma linja të shkëmbimit të energjisë, linjave nëntokësore të transportimit të naftës dhe gazin natyror etj. Rasti më i fundit është edhe ndërtimi i gazsjellësit transballkanik TAP që nis nga Azerbaxhani dhe kalon në disa vende të Ballkanit për të dalë në detin Adriatik.

Kjo rëndësi e pozitës gjeografike pritet të rritet edhe më tej në të ardhmen me integrimin e tërë rajonit në Bashkimin Evropian kur do të funksionojë tregu dhe zhvillimi i përbashkët.

## **7. 2 Kushtet natyrore**

Vendet e Ballkanit Perëndimor paraqitet me kushte natyrore shumë të larmishme. Në pamjen e përgjithshme dominojnë malet dhe malësitë, ku më të njohura janë: Dinariket, Alpet e Shqipërisë, Sharri etj. Këto male shtrihen në mënyrë të çrregullt nga veriu në jug, duke dhënë karakterin e një territori të lartë. Amplituda e lartësisë së relievit është e madhe dhe ndryshon nga niveli i detit deri në gati 3000 m lartësi.

Edhe pse fushat janë më të pakta, midis maleve apo në periferi të tyre gjenden megjithatë ultësira dhe zona fushore. Më të rëndësishmet midis tyre janë ultësirat përgjatë lumit Danub, Ultësira Perëndimore e Shqipërisë apo fushat ndërmaalore, si: fusha e Dukagjinit, Kosovës, Shkupit, Pollogut, Korçës etj. Shumë i rëndësishëm është edhe relievi bregdetar me shumë ishuj, gadishuj, gjire, plazhe etj. Nëntoka ndërtohet nga formacione të ndryshme gjeologjike të pasura me minerale të shumta, si: krom, bakër, hekur, plumb, zink, naftë, gaz natyror qymyre etj.

Ndërsa klima ndryshon nga ajo mesdhetare për shkak të daljes së gjërë në detin Adriatik e Jon dhe asaj kontinentale në brendësi dhe lindje. Gjithashtu format e relievit me male të shumta ndikojnë në krijimin e shumë mikroklimave. Këto kushte ndikojnë në ndryshimin e vlerave të temperaturës, reshjeve, erës etj. Si rregull vlerat e këtyre treguesve vijnë duke u rritur nga veriu drejt jugut.

Gjithashtu kjo pjesë e Ballkanit është shumë i pasur me ujëra. Kështu përveç deteve ka edhe shumë liqene, ku midis shumë të tjerëve të përmasave të vogla, duhet veçuar liqeni i Ohrid, Shkodrës, Prespës etj. Gjithashtu edhe lumenjtë janë të shumtë, ku veçohet sidomos lumi Danub, Sava, Drini, Buna, Semani, Vjosa etj.

Po kështu shumë e pasur është edhe bota bimore dhe shtazore me lloje të shumta të florës dhe kafshëve. Për shkak të klimës, relievit shumformësh dhe ujrave të shumta hasen disa kate bimore, duke filluar me atë të shkurreve mesdhetare e deri tek kullotat alpine. Në brendësi të kësaj bote të pasur bimore rriten edhe lloje të shumta të kafshëve, shpendëve dhe insekteve.

## **7. 3 Popullsia**

### ***Ecuria e zhvillimit të popullsisë***

Vendet e Ballkanit Perëndimor na prezantohet me një histori të lashtë dhe të mbushur me ngjarje e luftra të shumta. Kjo ka bërë që ato të paraqiten shumë të larmishme në popuj, kultura dhe gjuhë të ndryshme.

Popullimi i territorit ka filluar shuma herët dhe ai njihet për jetesën në të të tre prej popujve më të vjetër të Evropës, pikërisht: ilirët, grekën e lashtë dhe thrakët. Në periudhën romake pati ardhje

dhe vendosje të popullsisë romane. Shekult VI-VII-të u dominuan nga dyndjet e popullsisë sllave, të cilët zunë shumë pjesë të territorit të sotëm. Po kështu edhe perudha e gjatë e pushtimit osman u shoqërua me përzirje të shumta të popullsisë midis pjesëve të gadishullit.

Përcaktimi i kufijvë në vitin 1913 dhe Luftarat Botërore, sollën praninë e pakicave etnike në shtete të ndryshme politike që përbëjnë sot këtë pjesë të gadishullit.

Në shtetet përbërëse të Ballkanit Perëndimor jetojnë sot rreth 20 milionë banorë të shpërndarë si në tabelën e mëposhtme.

*Tab.1: Popullsia në vendet e Ballkanit Perëndimor*

Shtetet	Popullsia	Sipërfaqja	Dendësia	Kryeqyteti
Shqipëria	2.9 milionë	28 748 km <sup>2</sup>	101 b/km <sup>2</sup>	Tirana
Kosova	1.9 milionë	10 887 km <sup>2</sup>	179 b/km <sup>2</sup>	Prishtina
Maqedonia e Veriut	2.1 milionë	25 713 km <sup>2</sup>	79 b/km <sup>2</sup>	Shkupi
Serbia	7.8 milionë	77 474 km <sup>2</sup>	104 b/km <sup>2</sup>	Beogradi
Mali i Zi	635 mijë	13 812 km <sup>2</sup>	45 b/km <sup>2</sup>	Podgorica
Bosnje dhe Herzegovina	3.9 milionë	51 129 km <sup>2</sup>	77 b/km <sup>2</sup>	Sarajeva

Dendësia e popullimit ndryshon sipas kushteve të relievit dhe nivelit të zhvillimit ekonomik. Kështu viset më të populluara dhe njëkohësisht edhe me numrin më të madh të vendbanimeve janë zonat fushore, ato pranë bregdetit, luginat e lumenjve etj. Ndërsa zonat në brendësi, e sidomos ato malore, popullimi dhe numri i vendbanimeve është i pakët.

Kjo bën që treguesi i dendësisë së popullimit të ndryshojë shumë nga njëri shtet në tjetrin. Në shumicën e shteteve dendësia mesatare e popullimit luhet midis 50 dhe 100 b/km<sup>2</sup>, megjithatë në Kosovë, Serbi dhe Shqipëri ky tregues arrit të kalojë mbi 100 b/km<sup>2</sup>.

Shtimi natyror i popullsisë ka ardhur vazhdimisht duke u pakësuar, veçanërisht këto tre dekadat e fundit. Sipas shteteve, më problematike dhe madje me vlera negative paraqitet ky tregues në Bosnje dhe Serbi, ndërsa me vlera pozitive ky tregues paraqitet në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Shqipëri. Një situatë e tillë po rezulton me tendencën e uljes së numrit të përgjithshëm të popullsisë në pothuaj të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

Krahas rënies së shtimit natyror pothuajse të gjitha shtetet janë të prekura edhe nga largimi i shumtë i popullsisë nëpërmjet emigracionit jashtë vendit. Kjo e bën situatën demografike në këto vende edhe më problematike dhe kjo jo vetëm për të tashmen, por veçanërisht për të ardhmen.

#### **7.4 Përbërja kombëtare**

Popullsia e vendeve të Ballkanit Perëndimor është shumë heterogjene. Për shkak të ngjarjeve të ndryshme historike dhe luftrave të shumta, ka pasur ardhje, largime dhe përzirje të shumta të popullsisë. Edhe pse popujt më të lashtë janë ata me prejardhje ilire, për shkak të dyndjeve të mëdha sllave në shekujt VI dhe VII, ata përbëjnë sot numrin më të madh të popullsisë së këtyre vendeve. Pas tyre për nga numri vijnë shqiptarët, por të shumta janë edhe pakicat kombëtare, si: vlllehët, romët, egjiptianët etj.

Edhe struktura fetare paraqitet e larmishme. Janë tre besime kryesore fetare që shfaqen në këtë hapësirë, siç janë: besimi ortodoks sllav, besimi ortodoks grek dhe ai mysliman. Gjithashtu shumë i veçantë është edhe besimi bektashinj, i cili është sidomos i përhapur në Shqipëri, Kosovë dhe Bosnje.

Kjo larmi etnike dhe fetare i bën këto vende shumë të rëndësishme edhe për nga pasuria e veçantë dhe madhe kulturore që paraqesin. Në këtë kuptim territori i tyre është i mbushur me plot objekte, si të kulturës së vjetër ilire dhe antike, ashtu edhe me shumë objekte kulturore të

periudhave të mëvonshme.

## 7.5 Ekonomia

Për vendet e Ballkanit Perëndimor ekzistojnë mundësi shumë të mira për zhvillimin e tyre ekonomik. Këto mundësi lidhen si me potencialet shumta natyrore, ashtu edhe me ato humane dhe traditën e aktiviteteve të ndryshme që janë zhvilluar shumë herët.

Kështu pozita e favorshme gjeografike si hapësirë tranzite ku kalojnë akse të rëndësishme të zhvillimit tregtar, nëntoka me pasuri të ndryshme minerale, klima tranzitore dhe e larmishme, pasuritë e shumta ujore etj, kanë qenë dhe mbeten faktorë bazë për zhvillimin e tyre ekonomik. Gjithashtu popullimi shumë i hershëm i territorit ka bërë që edhe aktiviteti ekonomik të fillojë shumë shpejt në këto hapësira të gadishullit. Fillimisht kryesisht me aktivitete bujqësore e blektorale e në vazhdimësi me tregtinë, transportin, nxjerrjen e mineraleve dhe industrinë, turizmin etj.

Por, pavarësisht këtyre mundësive dhe potencialeve të shumta, ekonomia e tyre, marrë në tërësin, paraqitet më pak e zhvilluara në Evropë. Kjo si për arsye të luftrave të shumta dhe mungesës së stabilitetit për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ashtu edhe si rezultat të sistemit ekonomik komunist që kishin këto vende deri në vitin 1990.

Megjithatë, ndryshimet që po ndodhin në këto vende këto tre dekadat e fundit, premtojnë për një zhvillim shumë më të mirë të tyre në të ardhmen.

Një ndikim veçanërisht të rëndësishëm në këtë drejtim pritet të sjellë integrimi i plotë i rajonit dhe gjithë shteteve të tij në Bashkimin Evropian. Kjo nga njëra anë do të fuqizojë edhe më tej rolin ekonomik të pozitës gjeografike të gadishullit, nga ana tjetër do të rrisi shanset për shfrytëzimin më të mirë të potencialeve dhe të konkurrencës ekonomike.

## 7.6 Struktura e ekonomisë

Në strukturën ekonomike të shteteve përbërëse të Ballkanit Perëndimor dominon ajo bujqësoro-industriale. Kjo do të thotë që tradicionalisht ekonomia bujqësore ka luajtur rolin kryesor në zhvillimin e tyre ekonomik. Në tërësinë e tyre, apo me dallime të vogla, gjendja në zhvillimin ekonomik e të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor është e dobët.

Ekonomia bujqësore është e orientuar në prodhimin e produkteve të ndryshme bujqësore dhe blektorale. Veçanërisht në zonat më fushore zhvillimi i bujqësisë paraqitet më intensiv, ku falë kushteve të favorshme natyrore arrihen të merren edhe 2-3 prodhime në vit. Ndërsa në zonat kodrinore e malore vërehet më së shumti zhvillimi i blegtorisë dhe i kulturave të druja. Zonat bregdetare janë të njohura veçanërisht për kulturat mesdhetare, si: ulliri, vreshtaria, agrumet etj.

Nxjerrja e mineraleve është më së shumti i përqëndruar në Shqipëri, Kosovë, Serbi etj, në të cilët ndodhen edhe rezervat më të rëndësishme të boksideve, plumb-zingut, kromit, bakrit, qymyrit, naftës, gazit natyror etj.



Në kushtet e një teknologjie jo shumë moderne, industria përfaqësohet më së shumti me





Ndërsa nga lindja në perëndim përmasat tokësore të Evropës arrijnë në rreth 6 000 km nga malet Urale në lidje në brigjet portugeze të oqeanit Atlantik në perëndim. Vija e gjatë ujore e kufijëve të Evropës ka bërë që në të të përfshihen edhe shumë ishuj, gadishuj. Kjo ka bërë që Evropa të cilësohet si rajoni më e copëtuar e rruzullit tokësor.

Brenda këtyre kufijve, *Evropa cilësohet si rajoni ku në 1/30 e sipërfaqes së rruzullit tokësor jeton 1/10 e popullsisë botërore, rajoni ku ndërthuren forma të shumta të tokës dhe detit, rajoni i ndarjes në shumë nënrajone e zona të ndryshme, i klimës së butë e me shumë varacione, por edhe vendlindja e kulturave shumë të rëndësishme, e zhvillimit të civilizimit shoqëror dhe teknik, e më në fund rajoni që europianizojë botën.*

## 8.2 Larmia natyrore

Një nga tiparet më dalluese Evropës lidhet me larminë e madhe natyrore që ajo ofron. Ndonëse një rajon “i vogël” në raport me kontinentët e tjerë, në Evropë ndërthuren forma shumë të ndryshme të ndërtimit gjeologjik, relievit, klimës, hidrografisë, botës bimore dhe shtazore. Jo më kot Evropa cilësohet mozaiku apo muzeu gjeografik më i veçanti në botë me format nga më të ndryshme natyrore në një hapësirë të vogël gjeografike.

Kështu në *ndërtimin gjeologjik* të Evropës dallohen shumëllojshmëri shkëmbinjsh gjeologjikë, të cilët rezultojnë me pasuri të rëndësishme nëntokësore, veçanërisht qymyrguri (zona e Rurit, Donbasit, Uellsit etj), hekur (zona e Alzas Lorenës, Veriu i Suedisë, Uraleve etj), naftë (zona e Detit të Veriut, Rusia, Rumania, Shqipëria etj), si dhe shumë pasuri të tjera në përmasa më të vogla.

Për nga *format e relievit* Evropa cilësohet si rajoni tejet i larmishëm. Ndonëse më shumë se gjysmën e relievit të Evropës e zë relievi i ulët (fushat, pllajajat dhe rrafshnaltat), në të veçohen edhe shumë sistemi malore (Alpet, Masivi Qëndror, Pirenejt, Dinariket, Uralet etj), si dhe një vijë bregdetare tejet e thyer me shumë gadishuj dhe ishuj, të cilët në total zënë rreth 1/3 e gjithë sipërfaqes së Evropës.



*Klima e Evropës*, ndonëse përgjithësisht e butë, karakterizohet për ndryshime të shumta nga perëndimi i ngrohtë dhe me ndikim detar drejt lindjes së ftohtë e me ndikim kontinental, nga veriu subpolar drejt jugut mesdhetar etj. Këto kushte klimaterike shoqërohen me ndryshime të dukshme në vlerat e temperaturave, sasinë e reshjeve dhe rrezatimin diellor midis pjesëve të ndryshme të Evropës.

## 8.3 Identiteti historik dhe kulturor i Evropës

Kushtet natyrore dhe klimaterike të Evropës kanë qenë premiset e para dhe me ndikim shumë të fuqishëm në lindjen dhe zhvillimin e jetës njerëzore dhe larminë kulturore të saj.

Prandaj motoja e përgjithshme që karakterizon Evropën është ... *shumëllojshmëri dhe bashkejtesë*

*të formave natyrore me kulturë, popuj dhe gjuhë të ndryshme.* Në asnjë kontinent dhe rajon tjetër të botës këto elementë gjenden kaq të larmishëm dhe pranë njëri-tjetrit sa në Evropë.

Janë mbi 70 popuj që flasin gjuhë të ndryshme dhe 141 pakica kombëtare të organizuara në 46 shtete që bashkëjetojnë mes një diversiteti të madh historik e kulturor, të cilat e bëjnë të veçantë Evropën dhe e dallojnë atë dukshëm nga rajonet e tjera të botës.

Kjo pasuri e larmishme e bën të vështirë përcaktimin e një identiteti të qartë dhe të vetëm historik e kulturor të Evropës. Megjithatë rrënjët e këtij

identiteti duhet kërkuar thellë në historinë sa të vjetër aq edhe të re Evropës. Themelet e këtij identiteti fillojnë që me qytetërimin e Greqisë së

Lashtë e duke vazhduar më tej me kulturën dhe historinë romake, atë mesjetare dhe krishtërimin e Evropës, e deri në kohët moderne. Një sërë ngjarjesh historike, kulturore dhe politike krijuan hap pas hapi identitetin historik dhe kulturor të Evropës. Aq të rëndësishme kanë qenë këto ngjarje dhe ky identitet sa Evropa me të drejtë do të cilësohej si djepi i civilizimit botëror dhe do të europianizonte jo vetëm vetveten, por gjithë botën. Për gati gjysëm shekulli Evropa do të shkruante historinë botërore. Këtë rol pararojë në zhvillimin botëror Evropa do vazhdojë ta luaj në të ardhmen. Ajo është dhe do të mbetet hapësira e realizimit të inovacioneve globale.



#### **8.4 Evropa, lokomotiva e zhvillimit ekonomik botëror**

Evropa është jo vetëm vendlindja e shumë aktiviteteve ekonomike, por edhe lokomotiva e përçarjes së këtyre aktiviteteve në rajonet e tjera të botës. Rëndësia ekonomike e Evropës doli veçanërisht në pah me lindjen dhe zhvillimin e revolucionit industrial, i cili i nisur nga Evropa do të pushtonte shumë shpejt gjithë botë. Në këtë mënyrë Evropa ka qenë dhe është një faktor i rëndësishëm në kuadër të ekonomisë botërore, një konkurent shumë i fuqishëm përballë SHBA-së dhe vendeve të zhvilluara të Azisë.

Motoja ekonomike e Evropës është që ekonomitë e vendeve të veçanta të saj të rriten së bashku, të jenë sa më fleksible dhe liberale për të fituar kështu sa më shumë aftësi konkurruese në kushtet e globalizimit të ekonomisë botërore. Me këtë moto dhe tiparet që përcaktojnë prestigjin e saj ekonomik, veçanërisht në kuadër të BE, Evropa synon që të ruaj dhe të forcojë më tej rolin e saj udhrrëfyes në zhvillimet e sotme dhe të ardhshme të ekonomisë globale botërore.

Njëri nga treguesit më reflektues që tregon shkallën e zhvillimit ekonomik është niveli i të ardhurave për banorë. Këto të ardhura tregojnë sa është vlera e krijuar me punë në aktivitetet prodhuese dhe të shërbimit brenda vitit e pjesëtuar për banorë.

Marrë në tërësi, Evropa dallohet për nivel të lartë të ardhurash për banorë me mesatarisht rreth 15 000 euro për banorë. Megjithatë ky tregues ndryshon sipas vendeve të ndryshme në varësi të shkallës së tyre të zhvillimit. Kështu disa vende të Bashkimit Europian (10 prej tyre) kanë të ardhura që i kalojnë dyfishin e mesatares europiane, janë rreth 27 vende me të ardhura të nivelit mesatar, por ka edhe vende me të ardhura shumë më të ulta se vlera mesatare, siç janë: Moldvia, Kosova, Shqipëria, Bosnja etj.

## 8.5 Struktura e ekonomisë

Ekonomia e Evropës paraqitet e larmishme dhe e plotë me të gjitha sektorët dhe degët e ekonomisë së saj. Para së gjithash Evropa është vendlidja e procesit të industrializimit, i cili i nisur nga Evropa do të reflektohej më tej në gjithë botën. E filluar në Angli, industria u shtri si aktiviteti më i rëndësishëm ekonomik, veçanërisht duke filluar nga fundi i shekullit të XIX e në vazhdim, në gjithë vendet kryesore të Evropës (Gjermani, Francë, Itali) e më gjërë.

Në këtë mënyrë do të krijohet baza për një zhvillim modern dhe të qëndrueshëm. E filluar si një industri e rëndë e nxjerrjes dhe përpunimit të minerareve, me kalimin e viteve peshën kryesore të këtij zhvillimi do ta marrin degët e tilla, si: industria e ndërtimit të makinave, elektroteknika, inxhinjeria informatike etj



Evropa, duke pasur industri të zhvilluar, arriti të zhvilloj më tej dhe më mirë edhe bujqësinë. Kjo ka bërë që bujqësia e saj sot të paraqitet e zhvilluar dhe e shumllojshme, me shkallë të lartë të mekanizimit, kimizmit, numër të madh ekspertësh bujqësorë, me popullsi të arsimuar bujqësore, me rendimente të larta në bujqësi dhe në blegtori.

Një zhvillim të tillë e favorizojnë edhe kushtet e përshtatshme natyrore dhe tradita e marrjes me bujqësi, blegtori, peshkim etj. Të gjitha këto e kanë kthyer Evropën gjithnjë e më tepër nga importues në eksportues të shumë produkteve të ekonomisë bujqësore.

Krahas aktivitetit industrial dhe bujqësor, kalimi i Evropës gjithnjë e më shumë drejt një shoqëria konsumi, ka nxitur zhvillimin shumë të shpejtë edhe të sektorit të shërbimeve. Kështu krahas transportit dhe tregtisë është rritur gjithnjë e më shumë edhe roli i turizmit, hotelerisë, gastronomisë, telekomunikacionit etj. Kaq të shpejta dhe të rëndësishme kanë qenë këto zhvillime sa ato mbajnë tashmë peshën kryesore në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të shumë vendeve europiane.

## 8.6 Turizmi në Evropë

Në kuadër të gjithë botës, Evropa përballon mbi gjysmën të gjithë lëvizjes turistike, duke u cilësuar jo vetëm si djepi i lindjes së turizmit, por edhe kontinenti më i rëndësishëm turistik i botës. Mbi 600 milionë turistë regjistrohen mesatarisht çdo vit në Evropë, të cilët sjellin një efekt financiar mbi 500 bilion euro. Rreth 10% i të gjithë të punësuarve të Evropës ose gati 40 milionë njerëz, i përkasin sektorit turistik.


Evropa është jo vetëm kontinenti më i rëndësishëm pritës i turistëve, por njëkohësisht edhe furnizuesi më i rëndësishëm me turistë. Të gjitha këto tregojnë për rëndësinë e madhe që ka turizmi për Evropën.

Nga grafiku i mëposhtëm duket dominimi i Evropës si furnizuesi apo burimi kryesor i turistëve në botë me 52% të tyre. Më pas renditen Azia me Pacifikun, Amerika, Afrika dhe Lindja e Mesme.

Në këtë mënyrë Evropa vazhdon të mbajë peshën kryesore në lëvizjen turistike ndërkombëtare, qoftë si pritëse, ashtu edhe si furnizuese me turistë në botë.

Edhe pse dekadat e fundit, me rritjen e rëndësisë së shumë destinacioneve të tjera turistike, pesha e Evropës ka rënë nga 2/3 e lëvizjeve turistike ndërkombëtare në pak më shumë se gjysmën aktualisht, europianët mbetën megjithatë turistët dominues të botës.

Fig. 4: Peshë e Evropës në pritjen dhe furnizimin me turistë ndërkombëtar



Analizuar ky zhvillim në rajone të veçanta vërehen ndryshime të ndjeshme për sa i përket peshës dhe shpërndarjes gjeografike të turizmit. Për këtë qëllim ekzistojnë klasifikime të ndryshme në rajone dhe subrajone turistike, të kryera këto nga organizma të ndryshme botërore që merren me studimin e turizmit.

Ndonëse Evropa mban peshën kryesore në gjithë lëvizjes turistike në botë, midis pjesëve përbërëse të saj vërehen ndryshime në rolin që luajnë dhe peshën që mbajnë. Tabela e mëposhtme i shpreh qartë ndryshime të tilla.

Tab. 2: Ecuria e numrit të turistëve në Evropë (në milion)

Vitet	1990	2000	2010	2015	2016	Rritja në % (1990–2016)
<b>Evropa</b>	<b>261.5</b>	<b>386.5</b>	<b>489.0</b>	<b>603.7</b>	<b>616.2</b>	<b>135.6 %</b>
Evropa Veriore	28.7	44.8	62.8	75.4	80.2	179.4 %
Evropa Perëndimore	108.6	139.7	154.4	181.4	181.5	67.1 %
Evropa Qëndrore dhe Lindore	33.9	69.6	98.5	121.4	126.0	271.7 %
Evropa Jugore dhe Mesdheu	90.3	132.6	173.3	225.5	228.5	153.0 %

**Burimi:** Organizata Botërore për Turizëm 2017

Nga të dhënat e tabelës duket qartë që Evropa Perëndimore ka mbajtur dhe mban peshën kryesore në lëvizjen turistike të Evropës. Pas saj renditet Evropa Jugore dhe Mesdheu si rajon shumë i rëndësishëm turistik. Ndërkohë që rritje e konsiderueshme është vërejtur dy dekadat e fundit në Evropën Veriore me fuqizimin e mëtejshëm turistik të Britanisë së Madhe dhe vendeve skandinave. Por akoma më e madhe dhe e shpejtë është vërejtur kjo rritje veçanërisht në vendet e Evropës Qëndrore dhe Lindore pas rënies së sistemit komunist, duke filluar nga vitet 90-të të shekullit XX-të e në vazhdim. Në bazë të numrit të turistëve të regjistruar çdo vit, Organizata Botërore e Turizmit i

klasifikon shtetet më të zhvilluara turistike në botë, të cilët jepen si në tabelën e mëposhtme.


Tab.3: *Vendet me numrin më të madh të turistëve në botë (në milion)*

<i>Emri i shtetit</i>	1995	2005	2017	Ndryshimi i vendit që zë		
				1995	2005	2017
1. Franca	61.5	75.9	86.9	1	1	1
2. SHBA	44.8	49.2	76.9	2	3	3
3. Spanja	41.2	55.9	81.8	3	2	2
4. Italia	35.5	36.5	58.3	4	5	5
5. Kina	26.1	46.8	60.7	5	4	4
6. Anglia	25.8	28.0	37.6	6	6	7
7. Meksika	21.7	21.9	39.3	7	7	6
8. Hungaria	20.7	10.1	15.8	8	15	15
9. Polonia	19.4	15.2	18.4	9	12	14
10. Kanada	17.3	18.7	20.8	10	11	13
11. Austri	16.6	19.9	29.5	11	10	10
12. Gjermani	14.5	21.5	37.5	12	8	9
13. Hong Kong	11.7	14.7	27.9	13	13	11
14. Greqia	10.1	14.2	27.2	14	14	12
15. Turqi	7.1	20.2	37.6	15	9	8

**Burimi:** *Organizata Botërore për Turizëm 1996, 2006, 2018*

Mbi bazën e këtij koncentrimi kaq të madh të turizmit në pak vende, veçohen sot 10 vendet që rregjistrojnë numrin më të madh të turistëve në botë

Fig. 5: *Dhjetë vendet me numrin më të madh të turistëve në botë*



Tendenca të tilla në ecurinë e zhvillimit të turizmit në botë dhe Evropë priten të shoqërohen me rritje të mëtejshme të rëndësisë së tij në të ardhmen. Kështu nga njëra anë pritet të rritet edhe më shumë pjesmarrja e njerëzve në lëvizjen turistike dhe rritje e të ardhurave nga turizmi për shumicën e vendeve që ofrojnë atë. Nga ana tjetër pritet zgjerimi i mëtejshëm i hartës turistike të Evropës dhe botës dhe përfshirjes në të gjithnjë e më shumë vendeve dhe rajoneve konkurruese në turizëm.

## 8.7 Rajoni i Evropës Perëndimore

Evropa Perëndimore shtrihet nga malet Iberike në perëndim deri në malet Harz (Gjermani) në lindje dhe nga deti i Norvegjisë në veri deri në detin Mesdhe dhe Alpet e Evropës në jug. Shtetet

që bëjnë pjesë në këtë rajon janë: Franca, Gjermania, Belgjika, Holanda dhe Luksemburgu. Rajoni ka dalje të gjerë në oqeanin Atlantik, detin Mesdhe dhe Detin e Veriut.

Në jugperëndim të rajonit gjenden malet Pirenej ndërsa në juglindje Alpet. Ultësirat gjenden në Francë, Belgjikë, Holandë dhe Gjermani.

Hidrografia është mjaft e pasur dhe lumenjtë e rajonit përgjithësisht janë të lundrueshëm. Lumenjtë më të rëndësishëm janë: Reni, Danubi, Sena, Luara, Garona, Elba etj.

Klima është mesatare oqeanike dhe një ndikim të rëndësishëm në tiparet e klimës së rajonit jep rryma e ngrohtë e Golfstrimit, e cila kryen funksionin e një rezervuari ngrohtësie gjatë stinës së dimrit.

Evropa Perëndimore ka një numër të lartë popullsie, por si pasojë e rënies së nivelit të lindshmërisë, popullsia po vuan nga dukuria e plakjes. Gjithashtu ky rajon dallohet edhe për numrin e lartë të imigrantëve (popullsia e ardhur). Popujt e këtij rajoni i përkasin besimit të krishterë (katolikë dhe protestantë). Gjermania është vendi i lindjes së protestantizmit.

Për sa i përket ekonomisë, ky është një nga rajonet më të zhvilluara ekonomike-industriale të gjithë botës.

### **8.8 Rajoni i Evropës Ishullore**

Evropa Ishullore përbëhet nga dy ishuj: Britania e Madhe dhe Irlanda. Pozita gjeografike e rajonit është mjaft e favorshme pasi i gjithë rajoni ka dalje në det dhe nëpërmjet ngushticës La Mansh lidhet me rajonin e Evropës Perëndimore. Relievi përbëhet kryesisht nga fusha, ndërsa malet gjenden kryesisht në Skoci dhe Uells. Maja më e lartë ndodhet në veri të Skocisë, në malet Grampian me majën Ben Nevis me lartësi 1343m. Në jug të Skocisë gjenden malet Penine (të pasura me qymyrgur), që kufizohen në perëndim dhe lindje përkatësisht me fushat e Lankashirit dhe Jorkshirit. Hidrografia është e pasur me lumenj të shkurtër dhe me ujë të bollshëm, të përshtatshëm edhe për lundrim. Lumi më i rëndësishëm është Tamizi, pranë të cilit jeton rreth 1/5 e popullsisë së vendit. Klima është tipike oqeanike dhe reshjet janë të shpërndara në mënyrë pothuajse të njëtrajtshme përgjatë gjithë vitit (700-1000mm/vit).

Rajoni ka rreth 70 milion banorë me një dendësi popullsie që varion nga 271 b/km<sup>2</sup> në Britaninë e Madhe deri në 68 b/km<sup>2</sup> në Irlandë. Edhe ky rajon vuan nga dukuria e plakjes së popullsisë dhe pakësimi i grupmoshës së aftë për punë.

Rajoni dallohet për një ekonomi të zhvilluar, madje Britania e Madhe është një nga 7 vendet më të industrializuara të botës. Gjithashtu Britania e Madhe është vendlindja e Revolucionit I Industrial. Ky rajon nxjerr sasi të konsiderueshme nafte në Detin e Veriut. Centralet bërthamore japin rreth 20% të prodhimit të energjisë elektrike.

### **8.9 Rajoni i Evropës Veriore**

Rajoni i Evropës Veriore shtrihet në veri të Evropës deri në Rrethin Arktik të Veriut dhe përfshin gadishullin Skandinav, gadishullin e Jutlandës dhe ishullin e Islandës. Rajoni ka një vijë bregdetare tepër të thyer, duke formuar ishuj, gadishuj dhe gjire. Brigjet detare norvegjeze dallohen për fjordet e shumta (lugina akullnajore të përmytura nga deti). Islanda dallohet për vullkanet sipërfaqësore dhe gejzerët.

.Në perëndim të gadishullit Skandinav shtrihen malet Skandinave me lartësi deri në 2469m (maja Galdhopigen). Pjesa jugore e gadishullit Skandinav, Finlanda dhe Danimarka kanë një reliev fushor. Islanda ka një reliev malor dhe një pjesë e sipërfaqes së saj (12%) është e mbuluar nga akullnajat. Ky rajon zë vendin e parë në botë për burimet hidrike. Lumenjtë përgjithësisht janë të shkurtër dhe me shumë ujë. Rajoni dallohet për liqenet e shumta akullnajore, pjesa më e madhe e

të cilëve gjenden në Finlandë. Klima e rajonit është e ftohtë, me dimër të gjatë dhe verë të shkurtër e të freskët. Pjesa perëndimore e gadishullit Skandinav ka klimë më të zbutur për shkak të ndikimit të rrymës së Golfstrimit, ndërsa më në brendësi klima bëhet më kontinentale.

Rajoni i Evropës Veriore ka numrin më të vogël të popullsisë, me rreth 27 milionë banorë dhe me dendësi të popullsisë që varion nga 133 b/km<sup>2</sup> në Danimarkë deri në 3 b/km<sup>2</sup> në Islandë.

Ekonomia e rajonit është ndër më të zhvilluarat në Evropë. Këto vende dallohen për nivelin e lartë të standardit të jetesës dhe për uljen e pabarazisë midis të pasurve dhe të varfërve.

### **8.10 Rajoni i Evropës Qendrore**

Evropa qendrore shtrihet nga Gjermania në perëndim deri në Evropën lindore në lindje dhe përfshin këto shtete: Letoni, Lituani, Estoni, Poloni, Hungari, Çeki dhe Sllovakia. Vendet me dalje në det janë vendet baltike si edhe Polonia, me një bregdet kryesisht të tipit të ulët ranor.

Ky rajon ka një reliev përgjithësisht fushor. Në pjesën veriore shtrihet ultësira baltike dhe më në jug ultësira polake. Në pjesën jugperëndimore të Polonisë gjenden malet Sudete dhe Karpatet Perëndimore. Në jug të rajonit gjendet fusha e Danubit të poshtëm, e quajtur ndryshe si fusha e Panonisë. Hidrografia karakterizohet nga lumenj të tipit fushor dhe të lundrueshëm. Lumenjtë kryesorë janë: Danubi, Oderi, Vistula, Elba, Dvina Perëndimore etj.

Klima ndryshon nga oqeanike atlantike në vendet me dalje në det në kontinentale në vendet që ndodhen më në brendësi të kontinentit. Në Evropën Qendrore banojnë rreth 70 milionë banorë. Popullsia i përket besimit katolik. Shtimi i ulët natyror si edhe shkalla e lartë e emigracionit ka bërë që grupmosha në moshën e punës të pësojë një ulje të ndjeshme.

Ekonomia e rajonit ka pësuar ndryshime nga viti 1945-1990 dhe pas vitit 1990. Duke qenë se këto vende ishin pjesë e bllokut komunist në vitet 1945-1990, ekonomia u zhvillua me ritme të ngadalta, ndërsa pas vitit 1990 u zhvillua me ritme më të shpejta.

### **8.11 Rajoni i Evropës Lindore**

Evropa Lindore shtrihet nga Oqeani i Ngrirë i Veriut në veri deri në malet Kaukaze në jug dhe nga malet Urale në lindje deri në ultësirën gjermano-polake dhe malet Karpate në perëndim. Rajoni ka një vijë bregdetare të gjatë, ku gadishujt kryesorë janë gadishulli Kola, i Krimesë, Kanin etj. Porti më i madh është ai i Shën Petërburgut në brigjet e detit Baltik. Shtetet e rajonit janë: Rusia, Ukraina, Bjellorusia dhe Moldavia.

Në relievin e rajonit mbizotërojnë hapësirat e gjera fushore si fusha e Evropës Lindore ose ndryshe Fusha Ruse. Në lindje të Fushës Ruse gjenden malet Urale, me drejtim meridional. Lartësia maksimale arrin 1894m.

Hidrografia e rajonit është mjaft e dendur. Për shkak të terrenit fushor, lumenjtë janë të lundrueshëm. Lumi më i gjatë jo vetëm i rajonit, por i gjithë kontinentit të Evropës është Vollga (3531 km), që derdhet në detin Kaspik. Lumenj të tjerë janë Dniepri, Dnjestri, Doni, Dvina Veriore dhe Perëndimore, ndërsa liqenet kryesore janë Ladoga dhe Onega.

Klima është mjaft e larmishme, por gjithsesi mbizotëron klima kontinentale. Në Evropën Lindore banojnë rreth 170 milionë banorë.

### **8.12 Rajoni i Evropës Mesdhetare**

Rajoni i Evropës Mesdhetare përfshin gadishullin e Ballkanit, Iberik dhe atë Apenin. Shtrihet nga oqeani Atlantik në perëndim deri në Detin e Zi në lindje. Në veri rrethohet nga malet Pirenej, Alpet e Evropës dhe Karpatet. Në jug laget nga deti Mesdhe. Ishujt kryesorë të rajonit janë: Korsika, Sardenja, Sicilia, Korfuzi, Kreta, Malta etj.



Në këtë rajon mbizotëron relievi malor. Malet Pirenej ndajnë Spanjën nga Franca. Në pjesën veriore të Spanjës gjenden malet Kantabride, ndërsa në jug Alpet Betike. Pllaja e Mesetës zë pjesën më të madhe të gadishullit Iberik. Në veri të Italisë gjenden Alpet e Evropës. Ndërsa përgjatë gadishullit Apenin shtrihen malet Apenine me drejtim veri-jug. Përgjatë lumit Po shtrihet fusha e Lombardisë. Në gadishullin e Ballkanit gjenden Alpet Dinarike, Alpet e Shqipërisë dhe malet e Pindeve në Greqi. Në pjesën verilindore gjenden Karpatet në formë harku. Maja më e lartë e Ballkanit gjendet në malet Rodope me majën Musalla 2925m. Fushat kryesore janë: fusha e Danubit të poshtëm, ultësira e Maricës në Bullgari dhe Ultësira Perëndimore e Shqipërisë. Hidrografia është e pasur dhe lumenjtë kryesorë janë: Danubi, Duero, Tago, Po, Sava, Drava, Vardari etj. Ajo ndryshon nga atlantike në perëndim të rajonit, në mesdhetare në jug të tij dhe malore në lartësitë e maleve. Në këtë rajon banojnë rreth 200 milionë banorë. Ekonomia e rajonit karakterizohet nga disnivele të zhvillimit ekonomik,

### **8.13 Makrorajoni i Ruisë, tiparet natyrore**

Rusia shtrihet në dy kontinente (Evropë dhe Azi) dhe është shteti me sipërfaqen më të madhe në botë, që përfshin 11 zona orare. Ajo shtrihet nga Finlanda në perëndim deri në Alaskë në lindje.

Pjesa evropiane e Ruisë shtrihet nga Oqeani i Ngrirë i Veriut në veri deri në Detin e Zi dhe detin Kaspik në jug dhe nga kufiri me Ukrainën dhe Bjellorusinë në perëndim deri në malet Urale në lindje. Rreth 90% të territorit e zë Fusha Ruse. Malet Urale kanë drejtim veri-jug dhe shtrihen në një gjatësi prej rreth 2500 km. Ato janë male të vjetra, me lartësi të ulët, që nuk i kalon 2000 m dhe me pasuri të shumta minerale. Klima e Ruisë evropiane është tipike kontinentale. Hidrografia është e pasur me lumenj dhe liqene. Lumenjtë kryesorë janë: Vollga, Doni, Urali, Dvina etj, ndërsa liqenet më të mëdhenj janë: Ladoga, Onega etj.

Rusia Aziatike, që njihet ndryshe si Siberia, shtrihet nga malet Urale në Perëndim deri në oqeanin Paqësor në lindje. Klima në Rusinë Aziatike është e ashpër me temperatura shumë të ulëta, që shkojnë deri në -70°C. Reshjet janë të pakta (400-800 mm/vit).

Lumenjtë kryesorë janë: Obi, Jenisej, Amuri, Lena etj. Ndër liqenet më të mëdhenj përmendim: Kaspikun, që është dhe liqeni më i madh në botë dhe Bajkalin që është liqeni më i thellë në botë, me thellësi 1630 m.

Rusia ka një popullsi prej rreth 146 milionë banorë, por me një dendësi të ulët rreth 9 banorë/km<sup>2</sup>, për shkak të sipërfaqes së madhe. Rusia është e organizuar në shtet federativ, që ka në përbërje etni të ndryshme. Rreth 78% të popullsisë e përbëjnë rusët. Pjesa tjetër përbëhet nga ukrainasit, tartarët, çeçenet, armenët, kazakët etj.

Rusia është një nga vendet e zhvilluara të botës, ku pjesa evropiane e saj jep rreth 85% të prodhimit të përgjithshëm kombëtar të vendit.

## **Tema mësimore nr 9. Gjeografia e Botës**

### **9.1 Tiparet e përgjithshme natyrore të rajonit të Amerikës së Veriut**

Amerika e Veriut shtrihet nga oqeani Paqësor në perëndim deri në oqeanin Atlantik në lindje dhe nga oqeani i Ngrirë i Veriut në veri deri në kufirin me Meksikën në jug. Pozita gjeografikë është tepër e favorshme pasi nëpërmjet oqeanëve lidhet me Evropën dhe Azinë. Gadishujt më të mëdhenj janë gadishulli i Labradorit, Floridës, Alaskës etj.

Në pjesën perëndimore të Amerikës së Veriut mbizotëron relievi i lartë malor me malet Kordiliere dhe Shkëmbore, me lartësi mbi 6000 m. Në lindje gjenden malet e vjetra Apalache me lartësi deri në 1200 m, por të pasura në minerale, sidomos në qymyrgur. Në pjesën qendrore

gjendet baseni i Misisipit dhe rrafshnalta kanadeze.

Klima e Amerikës së Veriut është e larmishme. Në pjesën veriore mbizotëron klima polare dhe subpolare, më në jug klima mesatare, subtropikale dhe në kufi me Meksikën klima tropikale. Zona perëndimore dhe lindore me dalje në oqean, kanë klimë tipike oqeanike.

Hidrografia është shumë e pasur në lumenj dhe liqene. Lumenjtë më të rëndësishëm janë Misisipi, Misuri, Ohajo, Makenzi, Kolorado, Shën Lorenc etj. Nga liqenet më të rëndësishmit janë: Liqenet e Mëdha me origjinë tektonike (Liqeni i Sipërm, Huron, Miçigan, Ontario dhe Erie), të cilët përveç se lidhen me njëri-tjetrin, lidhen edhe me lumin Shën Lorenc. Ndërsa në Kanada ndodhen liqenet me origjinë akullnajore: si Liqeni i Skllevërve dhe Liqeni i Arinjve.

## **9.2 Tiparet e përgjithshme të popullsisë dhe ekonomisë së Amerikës së Veriut**

Amerika e Veriut përbën kontinentin ku jetojnë popuj të ndryshëm për nga raca, gjuha dhe kultura. Banorët vendas janë indigjenët, që zënë një përqindje shumë të ulët dhe që mendohet se kanë ardhur nga Azia në Amerikë nëpërmjet ngushticës së Beringut. Shumicën dërrmuese të popullsisë e përbën popullsia me origjinë evropiane, si anglezë, francezë, gjermanë etj. Rajoni ka një popullsi prej rreth 369 milionë banorë. Pjesa më e madhe e popullsisë është përqendruar në brigjet e Atlantikut, pranë Liqeneve të Mëdha, luginën e Misisipit, brigjet e Paqësorit etj. Popullsia shtohet me ritme të ulëta dhe imigrimi është në ritme të larta. Pjesa më e madhe e popullsisë flasin anglisht, më pas vjen spanjishtja dhe frëngjishtja.

Amerika e Veriut është poli më i zhvilluar ekonomik i botës. Ekonomia bazohet në parimet e konkurrencës dhe tregut të lirë. SHBA-ja dhe Kanadaja bëjnë pjesë në 8 vendet më të zhvilluara të botës. Ato dallohen për pasuritë e mëdha natyrore si naftë, gaz natyror, qymyr, hekur etj. Këto vende disponojnë nivel të lartë teknologjik, dhe të zhvillimit arsimor. Rajonet kryesore ekonomike në SHBA janë: Rajoni Verilindor (nga bregu i Atlantikut deri te Liqenet e Mëdha), Rajoni Jugor ku spikat zhvillimi i bujqësisë dhe Rajoni perëndimor (Kaliforni).

## **9.3 Rajoni i Amerikës Qendrore**

Rajoni i Amerikës Qendrore shtrihet midis Meksikës dhe Amerikës së Jugut. Dy zonat kryesore, që përbëjnë rajonin janë: pjesa e istmit (rrip i ngushtë toke) dhe pjesa ishullore (arkipelagu i Antileve). Në pjesën kontinentale mbizotëron relievi i lartë malor. Dy vargjet kryesore malore janë: Sierra Madre Lindore dhe Sierra Madre Perëndimore me lartësi mbi 5000 m. Pranë brigjeve detare shtrihen ultësirat. Në Panama arrihet pika më e ngushtë e istmit, rreth 65 km.

Klima përgjithësisht është tropikale e lagët. Megjithatë ndryshon në varësi të zonave. Në zonat malore për shembull, temperaturat janë më të ulëta se në zonat fushore, por gjithsesi nuk zbresin nën 10°C. Periudha nga qershori në nëntor është stina kur ndodhin më shumë ciklonet. Nga nëntori në maj është stina më e thatë dhe më e nxehtë, që mund të shfrytëzohen nga turistët për turizmin balnear.

Hidrografia e rajonit është e pasur. Lumenjtë kryesorë janë: Lempa në El Salvador, Ulua, Aguan në Honduras etj. Gjithashtu pjesë e rëndësishme e hidrografisë së Amerikës Qendrore është Kanali i Panamasë, që lidh oqeanin Atlantik me oqeanin Paqësor. Kanali i Panamasë u hap për herë të parë në vitin 1914, duke shkurtuar rrugën detare nga oqeani Atlantik për në oqeanin Paqësor. Popullsia e rajonit përbëhet kryesisht nga metisët dhe indianët. Ky rajon dallohet për qytetërimet e hershme maja dhe acteke.

## **9.4 Rajoni i Amerikës Jugore**

Amerika e Jugut shtrihet nga deti Karaibeve në veri deri në Kepin Horn në jug. Në perëndim

laget nga oqeani Paqësor dhe në lindje nga oqeani Atlantik. Në pjesën veriperëndimore bashkohet me Amerikën e Veriut nëpërmjet istmit të Panamasë, ndërsa ngushtica Drejk e ndan nga Antarktida. Në relievin e Amerikës së Jugut spikasin malet e larta të Andeve (me lartësi mbi 6000 m) në pjesën perëndimore, përgjatë brigjeve të oqeanit Paqësor. Në lindje të Andeve shtrihet rrafshnalta e Guajanës dhe e Brazilit, ndërsa në jug rrafshnalta e Patagonisë. Ndër ultësirat, më e madhja është ajo e Amazonës, me pellgun ujëmbledhës më të madh në botë. Fusha tjetër është ajo e Pampas, që shtrihet nga Argjentina deri në Uruguai.

Për shkak të shtrirjes së gjatë veri-jug, në Amerikën e Jugut dallohen disa lloje klimash: klima ekuatoriale e lagët, që përfshin kryesisht pellgun e Amazonës; klima mesatare e butë dhe më në jug klimë shkretinore. Hidrografia e rajonit është e bollshme. Lumi Amazona buron nga Andet dhe derdhet në oqeanin Atlantik. Është lumë me gjerësi të konsiderueshme që varion nga 11-40 km dhe mund të lundrojë edhe anije oqeanike. Lumenj të tjerë janë Orinoko, Rio de la Plata etj.

### **9.5 Rajoni i Afrikës Nënahariane**

Afrika Nënahariane shtrihet nga Saharaja në veri deri në kepin e Shpresës së Mirë në jug, duke përfshirë dhe ishujt përreth. Vija bregdetare është pak e përthyer, që do të thotë nuk ka shumë ishuj. Ishulli më i madh është Madagaskari në oqeanin Indian. Në relievin e Afrikës Nënahariane mbizotërojnë pllajtat. Mali më i lartë është Kilimanxharo që gjendet në ekuator, në kufirin midis Kenias dhe Tanzanisë.

Rajoni i Afrikës Nënahariane ka një klimë të ngrohtë, duke qenë se pjesa më e madhe e territorit gjendet në gjerësi të ulëta gjeografike. Dallojmë klimën ekuatoriale me temperatura të larta dhe reshje përgjatë gjithë vitit, klima tropikale në veri dhe në jug të ekuatorit, klima e shkretëtirave që dallohet për amplituda të larta ditore, si edhe klima subtropikale.

Lumenjtë kryesorë janë Nili, Kongo, Zambez etj. Liqeni më i madh në Afrikë është liqeni Viktoria. Liqene të tjerë janë Tanganika, Malavi, Eduard etj.

Rajoni ka një popullsi prej 250 milionë banorë, me një shtim të lartë natyror të popullsisë. Rreth 43% e popullsisë është nën moshën 15 vjeç. Në këtë rajon fliten më shumë se 1000 gjuhë.

Për sa i përket zhvillimit ekonomik është rajoni më i varfër dhe më rural i botës. Popullsia rurale në shtete të veçanta shkon deri në 85%. Shteti më i zhvilluar është Afrika e Jugut.

### **9.6 Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore**

Rajoni i Afrikës Veriore dhe Azisë Jugperëndimore shtrihet nga oqeani Atlantik në perëndim deri në Afganistan në lindje dhe nga deti Mesdhe në veri deri në shkretëtirën e Saharasë në jug. Në këtë rajon përveç shteteve të pavarura gjenden edhe dy territore: Bregu Perëndimor dhe Rripi i Gazës. Relievi përbëhet nga rrafshnalta dhe pllaja e thata, malet e shkretëtirat. Në pjesën veriperëndimore, në Marok, gjenden malet Atlas, në veri dhe në jug të Turqisë gjenden përkatësisht malet Pontike dhe Taurus, ndërsa në Iran malet Elbrus dhe Zagros.

Rajoni ka një klimë përgjithësisht të thatë, me reshje vjetore deri në 250mm/vit. Zonat që kanë dalje në detin Mesdhe marrin më shumë reshje, deri në 1000 mm/vit. Amplitudat ditore të temperaturave janë shumë të larta. Lumi më i gjatë jo vetëm i rajonit, por në gjithë botën është Nili, që rrjedh në drejtim të veriut dhe derdhet në detin Mesdhe. Lumenj të tjerë janë Tigri dhe Eufirati. Rajoni ka rreth 550 milionë banorë. Rajonet me popullsi më të dendur janë: lugina e Nilit, bregdeti i Mesdheut, luginat e lumenjve Tigër dhe Eufirat etj. Shtimi natyror i popullsisë është i lartë, si rezultat i nivelit të lartë të lindjeve.

Shtetet më të zhvilluara të rajonit janë: Kuvajti, Emiratet e Bashkuara Arabe, Katari, Bahrejni etj., ndërsa më të varfërat janë: Sudani dhe Jemeni. Rajoni është zhvilluar shumë ekonomikisht për

shkak të pasurive të shumta të naftës. Rreth 2/3 e gjithë rezervave botërore të naftës gjenden në këtë rajon.

### **9.7 Rajoni i Azisë Lindore**

Rajoni i Azisë Lindore shtrihet në pjesën lindore të Azisë me dalje në oqeanin Paqësor. Shtetet që bëjnë pjesë janë: Kina, Japonia, Mongolia, Tajvani, Koreja e Veriut dhe Koreja e Jugut. Pjesën më të madhe të territorit e zënë lartësitë e mëdha. Në pjesën jugperëndimore të rajonit gjendet rrafshnaltja e Tibetit me lartësi mbi 4000 m mbi nivelin e detit, e cila rrethohet nga malet e Himalajeve dhe Kun Lun. Shkretëtira e Taklamakanit gjendet në pjesën veriperëndimore midis maleve Tian Shan në veri dhe Kun Lun në jug. Në pjesën qendrore gjendet shkretëtira e Gobit. Fushat gjenden në pjesën lindore të rajonit, si p.sh. fusha e Mançurisë, e Kinës etj. Klima që mbizotëron është subtropikale dhe tropikale musonike. Në brendësi të territorit klima merr tipare kontinentale. Hidrografia është mjaft e dendur dhe lumenjtë më të mëdhenj janë: Huanhe, Jantze, Amur etj. Në rajonin e Azisë lindore aplikohen disa tipe të modeleve ekonomike. Modeli kinez i ekonomisë është ekonomia socialiste e tregut, që do të thotë se shteti garanton shpërndarjen e pasurisë në mënyrë të barabartë. Sot Kina është një nga vendet më të zhvilluara të botës. Japonia arriti kulmin e zhvillimit ekonomik me “mrekullinë japoneze” dhe sot ajo është një nga shtetet më të zhvilluara të botës. Koreja e Veriut dhe Koreja e Jugut ofrojnë dy tipe të ndryshme të zhvillimit ekonomik..

### **9.8 Rajoni i Azisë Juglindore**

Rajoni i Azisë Juglindore përfshin gadishullin e Indokinës, Malakës dhe pjesën ishullore të Filipineve dhe Indonezisë. Shtetet që bëjnë pjesë janë: Tajlanda, Mianmari, Laosi, Kamboxhia, Vietnami etj. Relievi është përgjithësisht malor. Në gadishullin e Indokinës gjenden vargjet malore që ndërthuren me luginat e lumenjve. Edhe pjesa ishullore ka relief malor. Ashtu si Azia Lindore edhe pjesa me dalje në oqeanin Paqësor e Azisë Juglindore bën pjesë në Unazën e Zjarrtë të Paqësorit (ndodhin rreth 80% e tërmeteve dhe vullkaneve).

I gjithë rajoni i Azisë Juglindore përfshihet nga musonet. Pjesa gadishullore ka klimë tropikale, ndërsa pjesa ishullore klimë ekuatoriale, me reshje të bollshme dhe temperatura të larta gjatë gjithë vitit. Hidrografia është e pasur si pasojë e reshjeve të bollshme. Lumenjtë kryesorë janë: Mekong, Irravad etj. Në këtë rajon banojnë rreth 574 milionë banorë.

Zhvillimi ekonomik ndryshon nga një vend në tjetrin. Shtetet më të zhvilluara janë: Singapori, Brunei, Malajzia, Tajlanda, Indonezia, Filipinet etj.

### **9.10 Rajoni i Azisë Jugore**

Rajoni i Azisë Jugore ka formën e një trekëndëshi me bazë nga lart, që në veri kufizohet me malet Himalaja, në perëndim laget nga deti i Arabisë dhe në lindje nga gjiri i Bengalit. Në këtë rajon përfshihen këto shtete: India, Pakistani, Bangladeshi, Butani, Nepali. Srilanka (Cejlon) dhe Maldivet.

Himalajet përbëjnë vargun malor më të lartë në botë, me majën Xhomolunga (8848m). Në veriperëndim gjendet shkretëtira Tar dhe në jug të maleve Himalaje shtrihet ultësira e Indo-Gangut. Pllaja e Dekanit shtrihet më në jug dhe rrethohet nga malet e Gateve Perëndimore dhe Gateve Lindore. Klima e rajonit është nën ndikimin e musoneve. Dallohet stina e lagët dhe stina e thatë.. Lumenjtë më të rëndësishëm të rajonit janë: Indi që buron nga Himalajet dhe derdhet në detin Arabik, Gangu, i cili pasi bashkohet me lumin Brahmaputra, në territorin e Bangladeshit formojnë deltën e madhe dhe derdhen në gjirin e Bengalit. Gangu është lum i shenjtë për

besimtarët hinduist. Azia Jugore ka një numër të lartë popullsie, për shkak të shtimit të lartë natyror. Pjesa më e madhe e popullsisë banon në zonat rurale. Dendësia e popullsisë është e lartë, rreth 400 b/km<sup>2</sup>. Gjuhët kryesore janë hindu dhe angleze, ndërsa besimet fetar që praktikohen janë hinduizmi, budizmi dhe myslimanizmi.

Dega kryesore e ekonomisë së rajonit është bujqësia, edhe pse e prapambetur. Shtetet më të zhvilluara janë India, Srilanka, ndërsa më të varftrat janë shtetet malore pa dalje në det si Nepali dhe Butani.

### **9.11 Rajoni i Australisë dhe Oqeanisë**

Australia dhe Oqania gjenden në Hemisferën Jugore. Në perëndim lagen nga oqeani Indian, ndërsa në lindje nga oqeani Paqësor. Australia është kontinenti më i vogël i planetit dhe ka një vijë bregdetare pak të thyer. Në jug të Australisë gjendet ishulli i Tasmanisë. Oqania përbëhet nga një grup i madh ishujsh në Paqësor, ndër të cilët dallojmë: Melanezinë në verilindje të Australisë, Mikronezinë në veri të Melanizisë dhe Polinezinë në juglindje të Melanezisë. Dy ishujt më të mëdhenj të Oqanisë janë: Guinea e Re dhe Zelanda e Re.

Relievi është përgjithësisht i ulët, përveç ishujve me origjinë vullkanike, të cilët kanë relief malor. Klima e rajonit ndryshon në varësi të faktorëve që ndikojnë. Australi ka një klimë tropikale kontinentale, ndërsa Oqania ka klimë ekuatoriale oqeanike.

Hidrografia e Australisë është e varfër për shkak të mungesës së reshjeve. Dy lumenjtë kryesorë janë Murrej dhe Darling. Në gjithë hapësirën e rajonit jetojnë vetëm 37 milionë banorë, me një dendësi popullore të ulët, 2 b/km<sup>2</sup>. Popullsia vendase e Australisë njihet ndryshe si aborigjenë, ndërsa në Zelandën e re, maorë. Pjesa më e madhe e kontinentit të Australisë është e pabanuar, për shkak të thatësisë. Shtimi natyror i popullsisë është shumë i ulët. Vendet më të zhvilluara të rajonit janë Australia dhe Zelanda e re.